

DHJETË VJEÇARI I PARË 1825-1835

1. Argëtimet e para me fëmijët – Predikimet – Akrobati – Grumbullimet në çerdhe

Ju më keni pyetur shpesh herë se në cilën moshë kam filluar të merrem me fëmijët. Në moshën dhjetë vjeçare unë bëja atë që ishte e përshtatshme për moshën time dhe që ishte një lloj oratori festiv. Dëgjoni. Edhe pse isha mjaft i vogël studioja ndërkohë karakteret e shokëve të mi. Dhe duke e fiksuar ndonjërin në fytyrë arrija të shihja planet që ai kishte në zemër. Për këtë arsye bashkëmoshatarët e mi më donin dhe më druanin.¹ Gjithkush më donte për gjyqtar o për shok. Nga ana ime bëja mirë kujt të mundja, por keq askujt. Shokët më donin shumë, vetëm se në raste grindje të mbaja anën e tyre. Kështu edhe pse i vogël në trup kisha forcën dhe guximin që ti fusja frikën shokëve edhe pse ishin me moshë më të madhe në lindje e ndonjë intrige, për ndonjë çështje, grindje të çdo lloji, unë bëhesha arbitër për grindjet dhe gjithë secili pranonte me dëshirë vendimin që shprehja me fjalë.

Por ajo që i bënte të mblidheshin rreth meje, dhe i bënte kënaqeshin deri në marrëzi, ishin ngjarjet që unë tregoja. Shembuj të dëgjuar në predikimet o në katekizëm; shkrimet e *Mbretërve të Francës*, e *Guerino Meschino*² i *Bertoldo*, *Bertoldino*, më furnizonin me mjaft material.³ Sapo më shihni shokët e mi, vraponin rreth meje për ti treguar ndonjë gjë atij që mezi arrinte të kuptonte në atë që kishte lexuar. Këtij grupi i shtoheshin mjaft të rritur, e nga ndonjë herë duke shkuar apo duke u kthyer nga Castelnovo, nga ndonjë herë në një fushë, në një livadh unë isha i rrethuar nga qindra vetë që vinin për të dëgjuar një fëmijë të shkretë, që përveç se pak kujtese, ishte bosh në shkencë, por para tyre shfaqej një doktor i madh: *Monoculus rex in regno caecorum*.⁴

¹ Don Bosko përdortet termin me drashtë në këtë kuptim “të kesh respekt e nderim”. Në botimin në italisht në pjesën mbi sistemin parandalues lexojmë: “Edukatori në mes nxënësve të kërkojë që ta duan, në se do të do të që ta druajnë”.

² Don Bosco shkruan: *Guarino*

³ *Mretërit e Francës* dhe *Guerino Meschino*: romane kavaleresk të mesjetës; të përkthyer në italisht nga Andrea Mangiabotti nga Barberino (1370-1431); në Itali u lexuan për një kohë të gjatë edhe në tetëqindën. *Bertoldo* e *Bertoldino*: novela të Giulio Cesare Croce (1550-1609). E para paraqiste një fshatar sakat për të zgjuar, i vlerësuar nga mbreti Alboino për inteligjencën e tij, pavarësisht nga liria që kishte për të vënë në lojë drejtuesit në fuqi.

⁴ Në një mbretëri të verbërish, kush ka një sy të vetëm bëhet mbret.

Gjatë stinëve të dimrit të gjithë më donin në stallë për ti treguar ndonjë histori.⁵ Aty mblidheshin njerëz të çdo moshe dhe të çdo shtrese, dhe të gjithë kënaqeshin që mund të kalonin pesë a gjashtë orë të mbrëmjes pa lëvizur duke dëgjuar tregimet e *Mbretërve të Francës*, i shkreti tregimtar rrinte drejt mbi një stol, që të ishte i dëgjuar dhe i shikuar nga të gjithë. Duke qenë se të gjithë thoshin se kishin ardhur për të dëgjuar predikimin, kështu që para dhe pas tregimeve të mia bënim të gjithë shenjën e kryqit të shenjtë me gjithë lutjen e *Të falem Mari*. 1826.

Gjatë stinës së ngrohtë, në mënyrë të veçantë në ditët e festave grumbulloheshim edhe fqinjët por kishte edhe mjaft nga jashtë. Këtu gjërat bëheshin më serioze. Unë bëja për të gjithë ndonjë arkëtim me lojra që edhe unë vetë i kisha mësuar prej të tjerëve. Shpesh në tregje e në panairë kishte palaço e akrobatë, që unë shkoja ti shihja, duke vëzhguar me vëmendje deri edhe lëvizjen më të vogël të tyre; pastaj shkoja në shtëpi dhe i përsërisja këto ushtrime deri sa arrija të bëja të njëjtën gjë. Imagjinoni se sa goditje, përplasje, të vrrat, laradashët më është dashur të pësoj. A do ta kishit besuar? Njëmbëdhjetë vjeç unë bëja lodra të tilla si me kupa, salto mortale, dallandyshen, ecja mbi litar, kërceja dhe vallëzoja mbi litar, si një akrobat profesionist.

Nga ajo që bëja në ditët e festes do të arrini të kuptoni se çfarë arrija të bëjë në ditë e tjera.

Tek Becchi ishte një livadh, ku atëherë kishte pemë të ndryshme, ku akoma edhe sot gjendet një dardhë martinelo,⁶ që në atë kohë më ndihmoi shumë. Në këtë pemë lidhja një litar, që e lidhja mirë tek një tjetër pemë që ndodhej pak më larg; dhe një tavolinë me një strajcë; prej kësaj një tapet në tokë për të bërë saltot. Kur kisha përgatitur çdo gjë dhe gjithë secili rrinte në ankth për të admiruar të rejat, atëherë i ftoja të gjithë të lutnin Ruzaren sipas shenjës së ditës, mbas të cilës këndohej një himn i shenjtë. Sapo mbaronte kjo hipja mbi karrige, bëja predikimin, o më mirë me thanë përsërisja atë që më kujtohej nga shpjegimi i ungjillit që kisha dëgjuar në mëngjes në kishë; ose tregoja gjëra dhe shembuj të dëgjuar o të lexuara në ndonjë libër. Mbas mbaroja predikimin bëja një lutje të shkurtër, dhe pastaj fillonin argëtimet. Në atë moment ju duhet të kishit parë, siç ju thashë, tregimtari shndërrohej në një palaço profesionist. Të bëjë fletën, salto mortalen, të ecja mbi duar me trupin lart; pastaj vija strajcën në kokë, të hash monedhat e pastaj ti gjesh në majë të hundës një e nga një; pastaj ti shumosh topat e vegjël, vezët, të shndërrosh ujin në verë, të vrasësh e të ndash në copa një pulë e pastaj ta bësh ringjallet dhe të kakarisë më mirë se përpara, ishin argëtimet e zakonshme. Pastaj ecja mbi litar sikur të ecja në një rrugë; hidhesha e

⁵ Gjatë netëve të gjata të dimrit fshatarët mblidheshin në stalla të ndriçuar nga një kandil dhe kalonin kohën duke lutur ruzaren, duke bërë punë dore, duke shkëmbyer lajmet e ditës, duke treguar përralla e legjendat tradicionale. Në këto raste ishte zakoni të lexoheshin edhe jetët e shenjtërve dhe romanet popullore. Për ndihmuar grumbullimet të tilla, Felice Cecca, famullitar i Villafranca Piemonte (Torino) kishte krijuar një udhëzues që pat shumë sukses pas botimit: *Vigjiljet e fshatarëve të krishterë. Dialogë familjarë të ndërtuar mbi fenë dhe mbi simbolet e saj, në përdorim të fshatarëve*.

⁶ *Dardhë martinelo*: emri në dialekt i një varjeteti dardhe tipike në Piemonte e në Francë, me fruta të vogla, që piqen në nëntor, ziheshin në verë me sheqer o me mjaltë.

përdridhesha, herë varesha me njëren këmbë, herë me të dyja këmbët; ngandonjëherë me të dyja duar, ndonjëherë vetëm me njëren. Pas disa orësh të këtij argëtimi kur isha i mjaft lodhur, pushonte çdo lojë, bëhej një lutje e shkurtër dhe gjithë secili u niste për rrugën tij.

Nga këto grumbullime ishin të përjashtuar të gjithë ato që kishin mallkuar, kishin bërë biseda të këqija, o kishin refuzuar që të merrnin pjesë në praktikën fetare.

Këtu ju do të më bënit një pyetje: për të shkuar në panairë, të tregje, për të parë palaçot, të sigurosh atë që duhej për ato dëfrime, ishin të nevojshme paratë, e këto ku i merrje? Për këto unë mund ti gjeja në mënyra të ndryshme. Të gjitha paratë që nëna ime o të tjerët me jepnin për ndonjë gjë të vogël; kusuret e vogla, dhuratat, çdo gjë ruaja për këto nevoja. Për më tepër unë isha specialist për përgatitjen e kurthave të zogjve, të bëja kafaze, kurthe me veshtull, me zënë me lak; isha shumë i mirë për të bërë foletë. Mbase bëja një sasi të mjaftueshme me këto objekte unë i shitja mjaft mirë. Kërpudhat, barin për të ngjyrosur,⁷ shqopë për fshesa⁸ ishin gjithashtu për mua një burim parash.

Këtu do më kishit pyetur: dhe nëna ime a ishte e kënaqur që bëja një jetë me kaq shpërdorime dhe të harxhoja kohën duke bërë akrobacira? Po ju them që nëna ima më donte shumë: dhe unë kisha një besim të pakufishëm në të, dhe pa miratimin e saj nuk do të kisha luajtur këmbën për asgjë. Ajo i dinte të gjitha, vëzhgonte çdo gjë dhe më linte të lirë. Në të vërtetë, kur kisha nevojë për ndonjë gjë me jepte me shumë dëshirë menjëherë. Edhe shokët e mi dhe në përgjithësi të gjithë spektatorët më jepnin me kënaqësi çka ishte e nevojshme për të siguruar kalimin e kohës sa më mirë.

2. Kungimi i parë – Predikimi i Misionit – Don Calosso – shkolla e Morialdos

Një gjë që më shqetësonte shumë ishte mungesa e një kishe o e një kapele ku mund të shkoja të këndoja, e të lutesha me shokët e mi. Për të dëgjuar një predikim o katekizmin, duhet të bëja një rrugë rreth dhjetë kilometër, për të shkuar e për tu kthyer, o në Castelnovo ose në vendin më të afërt në Buttigliera.⁹ Kjo ishte arsyeja për të cilin shkonim me dëshirë të dëgjonim predikimet e palaçove.¹⁰

Unë isha në moshën njëmbëdhjetë vjeçare kur më pranuan për kungimin e parë.¹¹ E dija krejt katekizmin e vogël, por askush nuk pranohej pa i mbushur dymbëdhjetë

⁷ *Barë ngjyruës (isatis tinctoria)* shkurre e vogël dhe që gjethet e saja përdoren për të ngjyrosur pëlhurat, industri shumë e zhvilluar në qytetin e Chieri.

⁸ *Shqopë*: shërbente për të bërë fshesa të vogla o furça për të krehur kuajt.

⁹ *Buttigliera d'Asti*: qendër bujqësore 2,5 km nga Castelnovo e 25 km nga Torino; në 1834 kishte 2170 banorë.

¹⁰ *Një gjë.....palaço*: A.S.F. lidh këtë paragraf mbas tregimit të kungimit të parë.

¹¹ Në 1825 famullitari i Castelnovo i shkruante arqipeshkvit: “Katekizmi i fëmijëve nuk bëhet vetëm në ditët e festave, por edhe çdo ditë gjatë Krezhmeve, kryesisht nga java e parë deri në atë të Vuajtjeve, që kështu të përgatiten për rrëfim dhe kungim pashvnor, në këtë kungim zakonisht pranohen djem dhe vajza të moshës 12 vjeçare, por ama shqyhen për aftësi dhe ndershmëri”. Funkcioni celebrrohej në periudhën e

vjeç. Nga që rrija larg nga kisha, famullitari nuk më njihte, e kështu që edukimi im fetar duhet të ishte pothuajse krejtësisht vetëm në mësimet e nënës sime. Duke qenë se dëshironte të mos më linte të shkoja më shumë në moshë pa marrë atë akt të madh të fesë sonë të shenjtë, iu vu punës ajo vetë që të më përgatis sa më mirë që të ishte e mundur. Gjatë Kreshmëve më dërgoi përditë në katekizëm. Pastaj më bënë provim, e kalova dhe pastaj u përcaktua dita në të cilën të gjithë fëmijët duhet të bënin Pashkën.

Në këtë mori gjërash ishte e pamundur të evitohej humbja e vëmendjes. Nëna ime studioi të më ndihmonte gjatë atyre ditëve; më kishte dërguar tri herë të rrëfhem gjatë periudhës së Kreshmëve. “Gjoni im, më thoshte vazhdimisht, Zoti po të përgatitë për një dhuratë të madhe; por përpiku të përgatitesh mirë, rrëfetu, të mos fshehësh as gjë gjatë rrëfimit. Rrëfe çdo gjë, pendohu për çdo gjë, dhe premtoi Zotit se do të bëhesh më i mirë në të ardhmen”. Çdo gjë premtova; në se pastaj kam qenë besnik atij premtimi, Zoti e di. Në shtëpi më bënte të lutesha, më vinte të lexoja ndonjë libër të mirë, duke më dhënë ato këshilla që një nënë e zellshme e shihte të arsyeshme ti jepte fëmijëve të saj.

Atë mëngjes nuk më la të flisja me askënd, më shoqëroi në meshën shenjte e më përgatiti dhe për falënderimin, që vikari i jashtëm, që quhej Sismondo,¹² që me shumë përkushtim ia bënte të gjithëve me zë të lartë dhe të alternuar. Atë ditë nuk më la që të merresha me asnjë punë tjetër, por vetëm të lexoja e të lutesha.

Ndër mjet shumë gjërash nëna ime më përsëriti shumë herë këto fjalë: “I dashur bir, qoftë për ty kjo ditë një ditë e madhe. Jam e bindur që Zoti me të vërtetë ka marrë në zotërim zemrën tënde. Tashti premtoi se do të bësh ç’të jetë e mundur se do të mbetesh i mirë deri në fund të jetës tënde. Për të ardhmen komuniko shpesh me të, por ki kujdes që të mos bësh sakrilegj. Thuaj gjithmonë çdo gjë në rrëfim, të jesh gjithmonë i bindur, shko me dëshirë në katekizëm e në predikime, por pash hatrin e Zotit largoj si prej sëmundjes atyre që bëjnë muhabete të mbrapshtë”.

I mora dhe vura në punë mësimet e prindit tim të devotshëm; dhe më duket se që nga ajo ditë kanë ndodhur përmirësime në jetën time, në mënyrë të veçantë në ndëgjësë e në bindje ndaj të tjerëve, që më përpara provoja një mospëlqim të madh, duke dashur të bëja gjithmonë reflektimet e mia feminare atij që më urdhëronte diçka o më jepte këshilla të mira.

Në atë vit (1826)¹³ një mision solemn që u zhvillua në Buttigliera, më dha mundësinë të dëgjoj shumë predikime. Fama e predikuesve tërhiqte njerëz nga të gjitha

Pashkës. Gjoni mbushi 11 vjeç me 16 gusht 1826, pra, me shumë mundësi, do të jetë pranuar në kungimin e Pashkës të 1827.

¹² *Giuseppe Sismondo* (1771-1827) qe famullitar i Castelnovo nga 1812 deri sa vdiq. Vikar i jashtëm, ishte titull që i jepej famullitarit që koordinonte famullitë e zonës (vikariati). Dioqeza e Torinos në atë kohë kishte 463.400 banorë; famullitë ishin 242 në ndara në 27 vikariate

¹³ Duhej të thonte 1829, në fakt don Calosso, për të cilin flasë pak më parë, u vendos si kapelan i Morialdos vetëm në muajt e parë të vitit 1829. Dy ishin jubiletë e celebruar në ato vite: një i caktuar nga Leoni XII për vitin e shenjtë 1826, tjetri i dhënë në mënyrë të jashtëzakonshme nga Piu VIII me 12 qershor 1829, me rastin e zgjedhjes së tij. Arqipeshkvi i Torinos, Colombano Chiaveroti, caktoi celebrimin e jubileut për dioqezën e tij nga 8 deri me 22 nëntor, “kur përfundojnë verimet, dhe punët më të rënda në fusha që çdo njeri të cilitdo rang ta kishte më të lehtë ta ndiqte” (Letër baritore e 30 gushtit

anët. Edhe unë shkoja me shumë të tjerë. Mbasi bënin mësim dhe një meditim në mbrëmje, linin të lirë dëgjuesit që të shkonin në shtëpi.

Në një nga ato net të prillit, drejtohesha për në shtëpi në mes të atij grumbulli njerëzish, e në mes nesh ishte dhe një farë don Calosso nga Chieri,¹⁴ një njeri shumë i devotshëm, edhe pse i përkulur nga vitet bënte atë copë rrugë për të dëgjuar misionarët. Ai ishte kapelan i Morialdos. Duke parë një fëmijë me trup të vogël, me kokë të zbuluar, me flokë të drejtë dhe që ecte në heshte të plotë në mes të tjerëve pamja ime e tërhoqi dhe mbi mua ra shikimi i tij e filloi të më flasë kështu:

- Biri im, nga vjen? A je duke shkuar edhe ti në mision?
 - Po, zotëri, jam duke shkuar në predikimin e misionarëve.
 - E çfarë mund të kuptosh ti! Ndoshta nëna mund të bënte një predikim më të përshtatshëm, a është e vërtetë?
 - Është e vërtetë, nëna ime më bën dëndur predikime të mira; por shkoj me shumë dëshirë të dëgjoj ato misionarë dhe më duket se i kuptoj.
 - Në se më thua katër fjalë të predikimit të sotëm unë të jap një qindarkë.
 - Më thuaj vetëm në se dëshiron që unë ti them nga predikimit i parë o të dytë.
 - Si të duket më mirë ty, vetëm të më thuash katër fjalë. Të kujtohet se për çfarë fliste predikimi i parë?
 - Në predikimin e parë flitej për nevojën për t'ju dhënë Zotit në kohë dhe jo të vonohemi në konvertim.
 - Dhe çfarë u tha në këtë predikim? – shtoi plaku i nderuari mjaft i mrekulluar.
 - Më kujtohet mjaft mirë dhe në se do ta dëgjosh ta them përmendësh të gjithë.
- Dhe pa pritur përgjigje fillova ti përshkruaj hyrjen, pastaj tri pikat, pra ai i cili duke vonuar në konvertim e ndjek një rrezik i madh që i mungon koha, hiri o vullneti. Ai më la të vazhdoja për një gjysmë ore në mes të grumbullit të njerëzve; pastaj më mori në pyetje kështu: “Si quhesh, prindërit e tu, a ke bërë shumë shkollë?”
- Unë quhem Gjon, babai im vdiq kur isha akoma fëmijë i vogël. Nëna ime është e ve me pesë krijesa për ti ushqyer. Kam mësuar të lexoj dhe di pak të shkruaj.
 - Nuk ke studiuar Donaton o gramatikën?¹⁵

1829, Torino, Eredi Botta shtampues arqipeshkvnor, 1829, 2-3). Këtu don Bosco ngatërron një jubile me tjetrin.

¹⁴ *Giovanni Melchiorre Felice Calosso* (1760-1830), lindur në Chieri, i laureuar në Teologji në Universitetin e Torinos. Kishte qenë famullitar në Broino (një vend 25 km nga Torino) nga 1791 deri në 1813; qe i shtrënguar të jepte dorëheqjen për shkak të fushate shpifje të orkestruara nga disa jakobin të famullisë. Mbasi kishte zhvilluar për vite detyrën e bashkëpunëtorit të famullisë në Carignano, u transferua në Morialdo në pranverë të vitit 1829.

¹⁵ *Donato*: term i përdorur për të treguar gramatikën latine. Ka prejardhjen nga emri i një gramatike romane e shek. IV pas Krishtit, Elio Donato (mësues i Shën Girolamo dhe i Rufino d'Aquileia), autor i dy traktateve gramatikore, të përdoruara gjatë shekujve në shkollat latine; *Ars minor*, tekst fillestar mbi tetë pjesë të diskutimit, dhe *Ars maior*, mbi stilistikën dhe metrikën. Në Piemonte termi *Donato* tregon gramatikën për klasat e Latinishtes inferiore: *Donato përdor bazat e gjuhës latine dhe italiane*. Torino, Shtypshkronja Mbretërore, 1815. Gjon Bosko me shumë mundësi përdori këto botim, ose ndoshta atë më të hershem: *Donato i janë shtuar pjesë dhe është i ndarë në dy pjesë*. Torino, Shtypshkronja Mbretërore, 1824. Me termin *Gramatikë*, në fakt, tregon një material të përdorur në klasat e larta: *Metoda e re për të*

- Nuk e di se çfarë janë.
- A do të doje të studioje?
- Shumë, shumë.
- Çfarë të pengon?
- Vëllai im Antonio.
- Përse Antonio nuk të lë të studiosh?
- Sepse duke qenë se ai nuk ka dashur të shkojë në shkollë, më thotë se nuk do që të tjerët të humbin kohën duke studiuar siç ka humbur ai kohë, por në se unë do të mund të shkoja, do të studioja patjetër e nuk do të humbisja kohë kot.

- Për çfarë arsyeje dëshiron të studiosh?
- Për të përqafuar jetën e klerikut.
- Për cilën arsye dëshiron këtë jetë?
- Për t'ju afruar, folur, për ti mësuar në besim shumë shokëve të mi, që nuk janë të këqij, por bëhen të tillë, sepse askush nuk ka kujdes për to.

Kjo mënyrë e sinqertë dhe e guximshme e të folurit tim i bëri shumë përshtypje këtij prifti të shenjtë, sa ndërsa unë flisja ai nuk mi hoqi kur sytë asnjë herë prej meje. Mbasi mbërritëm në një farë pike të rrugës, ku ishim të detyruar të ndaheshim, më la me këto fjalë: “Rri i qetë; unë do të mendoj për ty e për arsimimin tënd. Të dielën eja me nënën tënde të më shohësh dhe do të merremi vesh për çdo gjë”.

Të dielën që erdh shkova në fakt me nënën time dhe i tha se do të ishte ai vetë që do të më kishte bërë shkollë, një herë në ditë, **duke ma zënë pjesën tjetër me punë në fushë për të paguar vëllanë Antonio**. Ky u kënaq kollaj, që e gjitha kjo të fillonte pas verës, kur punët e fushës nuk të japin ndonjë shqetësim të madh.

Unë u vendosa në duar e Don Calossos, që vetëm prej pak muaj ishte vendosur në atë kapelë. E bëra të njihte krejt veten time. Çdo fjalë, çdo mendim, çdo veprim ia tregoja menjëherë. Kjo i pëlqej shumë, sepse me një mënyrë të tillë do të mund të rregullohesha nga ana shpirtërore dhe kohore që në themel.

Atëherë njoha se çfarë do të thoshte të kishe një udhëheqës të vazhdueshëm, një mik besnik të shpirtit, nga i cili deri në atë moment kisha qenë i privuar. Ndër të tjera gjëra më ndaloi të bëja një pendesë të fortë, që unë zakonisht e bëja, jo e përshtatshme për moshën dhe në gjendjen time. Më nxiti të frekuentoj rrëfimin dhe kungimin, dhe më tregoi për rreth mënyrës se si çdo ditë të bëja një meditim ose më mirë të them të bëja një letër shpirtërore. Të gjithë kohën që kisha gjatë ditëve të festave e kaloja pranë tij. Në ditët e pushimeve, për sa të ishte e mundur, shkoja të shërbeja në meshën shenjte.

Nga ajo periudhë kam filluar të shijon se çfarë do të thoshte jetë shpirtërore, ndërsa përpara veproja më tepër materialisht dhe si një makinë që bën një gjë, pa e ditur arsyen.

Në mes të shtatorit kam filluar rregullisht të studioj gramatikën italiane, që për një kohë të shkurtër munda ta mbaroj dhe ta praktikoj me detyra të përshtatshme. Për

Krishtlindje kam përfunduar Donaton, për Pashkë fillova përkthimet nga latinishtja në italisht e anasjelltas. Gjatë të gjithë asaj kohe nuk jam shkëputur asnjëherë nga argëtimet festive në livadh, o në stalla gjatë dimrit. Çdo fakt, çdo e thënë dhe mund të them çdo fjalë e mësuesit më shërbente për të mbajtur dëgjuesit e mi.

Unë mendoja se ndihesha i lumtur që kisha arritur të plotësoja dëshirat e mia, kur një fatkeqësisë e re, përkundrazi një fatkeqësi e rëndë më preu në rrënjë fillin e shpresave të mia.

3. Studimi dhe shati – Një e re e keqe dhe një e mirë – Vdekja e Don Calossos

Deri sa zgjati dimri dhe punët e fshatit nuk kërkonin ndonjë kujdes të veçantë Antonio vëllai im më linte kohë të lirë të merresha me gjërat e shkollës. Me ardhjen e pranverës filloi të ankohej duke thënë që atij i duhej të harxhonte jetën në punë të lodhshme e të rënda ndërsa unë humbja kohë duke bërë jetën e një zotërie. Mbas diskutimesh të forta me mua e me nënën time, për të ruajtur paqen në familje u vendos që unë do të shkoja në mëngjes në shkollë dhe pjesën tjetër të ditës do të kisha bërë punë të ndryshme. Por si mund të arrija të mësoja? Si të bëja përkthimet?

Dëgjoni. Duke shkuar e duke u kthyer nga shkolla ishte pak kohë për të studiuar. Sa mbërrija pastaj në shtëpi, merrja shatin me një rën dorë, dhe me tjetrën gramatikën dhe përgjatë rrugës studioja *Qui quae quod, qualora è messo* etc.¹⁶ deri tek vendi i punës; pastaj, duke i hedhur një vështrim të dhembshur gramatikës, vendosesha në qoshe të fushës e filloja të mihja, të prashisja ose të shkulja barin me të tjerët sipas nevojave.

Në orën kur të tjerët fillon të hanin bukë unë tërhiqesha në një anë, dhe me një rën dorë mbaja copën e bukës duke e ngrënë, dhe me tjetrën mbaja librin që po studioja. Të njëjtin veprim bëja duke u kthyer për në shtëpi. Ora e drekës, e darkës, duke vjedhur kohë pushimit ishte e vetmja kohë që më mbetej për detyrat e mia me shkrim.

Pavarësisht punës së madhe dhe vullnetit të mirë vëllai im Antonio nuk ishte i kënaqur. Një ditë me nënën time, e pastaj me vëllanë tim Giuseppen, me një ton urdhërues tha: “Është mjaft e qartë. Dua që ta mbyll me këtë gramatikë. Unë jam bërë i madh e fortë pa parë kurrë këto libra”. I mbizotëruar në atë moment nga e keqja dhe zemërimi, iu përgjigja me fjalët që nuk duhet ti thosha: “Ti flet keq, i thashë. Nuk e din se gomari jonë është më i madh se ti e nuk ka shkuar kurrë në shkollë? A do të bëhesh i ngjashëm me të?”. Mbas këtyre fjalëve u hodh me shumë zemërim, e vetëm me këmbët, që më hynë shumë në punë, mundja të ikja e ti shpëtoja një lumi goditjesh e shpullash.

Nëna ime ishte shumë e trishtuar, unë qaja; kapelani i dëshpëruar. Ai shërbëtor i denjë i Zotit i vënë në dijeni për problemet e ndodhura në familje, në thirri një ditë e më

¹⁶ Fillimi i një rregulle gramatikore latine që në Metodën e re ishte e formuar në rimë, për të thjeshtëzuar të mësuarit.

tha: “Gjoni im, ti ke vendosur në mua besimin tënd, dhe nuk dua që kjo gjë të shkoj kot. Lëre pra vëllanë tënd të pashpirt e eja me mua dhe do të kesh një atë të dashur”.

Vura në dijeni nënë time për atë propozim bamirës, e u bë festë në familje. Në muajin e prillit fillova të jetoj me kapelanin, duke shkuar në shtëpi veç për të fjetur.

Nuk mund të imagjinonin kënaqësinë time të madhe. Don Calosso ishte kthyer për mua në idhull. E doja më shumë se një babë, lutesha për të, e shërbeja me dëshirë në të gjitha gjërat. Ishte për mua një kënaqësi e madhe të lodhesha për të, e do të jepja jetën për gjërat që atij i pëlqenin. Unë bëja shumë përparime në një ditë me kapelanin, sa nuk do të arrija të bëja në shtëpi gjatë një jave. Ai njeri i Zotit më jepte aq shumë dashuri që shpesh herë më thoshte: “Mos u shqetëso për të ardhmen tënde; derisa të jem gjallë, nuk do të që të mungojë asgjë; dhe në se vdes gjithashtu do të siguroj”.

Punë e mia do të ecnin me një mbarësi të pabesueshme. Unë ndihesha plotësisht i lumtur, asnjë gjë nuk më mungonte që të mund ta dëshiroja, kur një fatkeqësi preu në rrënjë të gjitha shpresat e mia.

Një mëngjes prilli të vitit 1827¹⁷ Don Calosso më dërgoi tek familjarët e mi për të marrë diçka; sapo kisha arritur në shtëpi kur një person pafrymë prej vrapimit të tha të shkoja shpejt te Don Calosso, e kishte goditur një sëmundje e rëndë, dhe, donte të më shihte. Nuk vrapova, por fluturova pranë bamirësit tim, që fatkeqësisht e gjeta në shtrat i pazoti të fliste. Ishte goditur nga një goditje hemorragjia cerebrale. Më njohu, donte të fliste, por nuk ishte i zoti të lidhte një fjalë. Më dha çelësin e parave, duke bërë shenjë që të mos ia jepja askujt. Por pas dy ditëve agoni i shkreti Don Calosso dërgoi shpirtin në gjirin e Krijuesit, me të vdiste çdo shpresë e imja. Jam lutur gjithmonë për të dhe deri sa të kem jetë nuk do të lë pa bërë çdo ditë lutje për këtë bamirës fisnik.

Erdhën trashëgimtarët e don Calossos, dhe atyre ia dorëzova çelësat dhe çdo gjë tjetër.

4. Don Cafasso – Pasiguritë – Ndarja vëllazërore – Shkolla e Kastelnuovo në Asti – Muzika - Rrobaqepësi

Në atë vit provania hyjnore më bëri të takohem me një bamirës të ri: Don Giuseppe Cafasso nga Castelnuove i Astit.¹⁸

¹⁷ Donte të thoshte nëntor 1830; don Calosso në fakt vdiq me 21 nëntor 1830, siç rezulton nga regjistrat famullitarë të Castelnuovo: “

¹⁸ Don Bosco shkruan gjithmonë *Caffasso*, duke italianizuar shqipëtimin dialektor të mbiemrit. Giuseppe Cafasso (lindur me 15 janar 1811 - vdiq me 23 qershor 1860), bashkëfshatar i don Boscon, do të jetë rrëfyeshi i tij dhe ati shpirtëror. Ishte shuguruar meshtar në moshën 22 vjeçare (1833), frekuentoi Konviktin Kishtar të Torinos për përsosje baritor, nën udhëheqjen e teologut Luigi Guala, që bëhet më vonë bashkëpunëtor i tij. Qe një njeri i lutjes, i një jetë thellësisht të përvujtë, çdo gjë e kushtuar shërbimit baritor dhe mësimdhënies të teologjisë morale. I palodhur për të predikuar, në rrëfime dhe në drejtimin shpirtëror, pat një ndjeshmëri shumë të madhe ndaj të varfërve dhe të burgosurve, që i vizitonte rregullisht dhe i ndihmonte ekonomikisht. Me një dashuri të ëmbël gjendej për të ngushëlluar të dënuarit me vdekje. Ndikoi shumë në lulëzimin e shenjtërisë meshtarake që karakterizoi kishën piemonteze

Ishte e diela e dytë e tetorit (1827) dhe banorët e Morialdos festonin të Zanunin e Zojës së Bekuar, që ishte festa më rëndësishme për atë zonë. Gjithsecili kishte punë në shtëpi o në kishë, ndërsa të tjerët ishin spektatorë ose merrnin pjesë në lojëra o në dëfrime të ndryshme.

Në çdo shfaqje që unë bëja shihja një seminarist, të shkurtë, me sy që i shkëlqenin, i sjellshëm, fytyrë engjëlli.¹⁹ Ai ishte i mbështetur në derën e kishës. Unë qeshë i mahnitur nga pamja e tij dhe pavarësisht se isha në moshën dymbëdhjetë vjeçare, i mbërthyer nga dëshira për ti folur, iu afrova dhe fillova ti flisja me këto fjalë; “Zoti abat, dëshironi të shihni ndonjë shfaqje në festën tuaj? Unë do ta bëj atë se çfarë dëshironi shumë mirë”.

Ai më bëri një shenjë të hijshëm që ti afrohem dhe filloi të më merrte në pyetje mbi moshën time, mbi studimin, se a e kisha marrë kungimin e shenjët, sa shpesh shkoja të rrëfeshesha, ku e ndiqja katekizmin e gjëra të tilla. Unë mbeta si magjepsur nga ajo mënyrë e të folurit; iu përgjigja me dëshirë çdo pyetje; pastaj si për ta falënderuar për mirësjellje, ia përsërita ofertën për ta shoqëruar të vizitonte ndonjë shfaqje o ndonjë gjë të re.

- Miku im i dashur, vazhdoi ai, shfaqjet e meshtarëve janë funksionet e kishës, me sa më shumë devotshmëri që ato të celebren, aq më shumë të vlefshme ia dalin shfaqjet tona. Të rejat tona janë praktikat e fesë që janë gjithmonë të reja dhe për këtë arsye duhet të frekuentohen me përkujdesje; unë pres vetëm që të hapet kisha që të mund të hyj.

Mora zemër dhe vazhdova diskutimin, e shtova: “Është e vërtetë ajo se çfarë më thoni, por ka kohë për çdo gjë: koha për të shkuar në kishë e për tu çlodhur”.

Ai filloi të qeshte dhe e mbylli me këto fjalë të paharrueshme, që ishin si një program veprimi për gjatë gjithë jetës sime: “Ai, i cili përqafton jetën kishtare i dhurohet Zotit, e për sa sheh në botë, as gjë nuk duhet ti rrijë më për zemër se sa që çdo gjë që është për lavdinë e Zotit dhe për të mirë të shpirtrave”.

Atëherë krejt i mrekulluar, desha të dija emrin e këtij seminaristi, fjalët e të cilit dhe sjellja e tij manifestonin shpirtin e Zotit. Mora vesh se ai ishte kleriku Giuseppe Cafasso, student i vitit I në teologji, për të cilin kisha dëgjuar mjaft herë të flitej si ishte një pasqyrë e virtytit.²⁰

Vdekja e Don Calossos që për mua një fatkeqësi e pandreqshme. Unë qaja në mënyrë të pangushëllueshme për bamirësin tim të vdekur. Në se isha zgjuar mendoja për të, në se flija ëndërroja atë; gjërat shkuan gjatë, sa dhe nëna ime, duke pasur frikë për shëndetin tim, më dërgoi për do kohë tek gjyshi im në Capriglio.²¹

ndërmjet vitet ‘800 dhe ‘900. U shpall shenjtë në vitin 1947, dhe është mbrojtësi i të burgosurve. Piu XII, në thirtjen *Menti nostrae* (1950), e tregoi si modelin e meshtarëve që “që kanë kujdes shenjtërimin e bashkëvëllezërve, si këshilltarë o si rrëfyer o si drejtues shpirtëror”.

¹⁹ Giuseppe Cafasso kishte veshur petkun e seminaristit me 1 korrik 1827, në moshë 16 vjeçare.

²⁰ Tregimi i takimit me seminaristin Cafasso është përshkruar nga Gjon Bosco.

²¹ Ishte babai i nënës, Melchior Occhiena (1752-1844).

Në atë kohë pashë një ëndërr tjetër në të cilën qeshë i qortuar ashpërsisht sepse kisha vendosur shpresën time tek njerëzit dhe jo në mirësinë e Atit qiellor. Ndërkohë vazhdimisht më shoqëronte mendimi që të përparoja në studime. Unë shihja mjaft meshtarë të mirë që punonin në shëlbimin shenjtë, por nuk arrija të kisha me to asnjë familjaritet.

Shpesh vinte të më takonte prevosto²² me zëvendësin e tij. I përshëndesja nga larg, dhe kur afroreshin i përshëndesja duke u përkulur. Dhe ata në mënyrë hije rëndë dhe të sjellshme më kthenin përshëndetjen dhe vazhdonin rrugën. Shpesh herë duke qarë i thosha vetes por dhe të tjerëve: “Në qoftë se do të isha prift, do të kisha bërë ndryshe: do të kisha pasur dëshirë t’ju afrohesha fëmijëve, do ti kisha thënë atyre fjalë të mira, ti jepja këshilla të mira. Sa i lumtur i lumtur do të isha, në se do të mundja të flisja pak me famullitarin tim. Këtë ngushëllim e pata me Don Calosso, a thua nuk do ta kem më?”.

Nëna ime duke më parë akoma të pikëlluar për vështirësitë që ishin ndërmjet studimeve të mija dhe dëshpërimin për të marrë miratimin e Antonios, që tashmë po i kalonte të njëzetat, dha lejen që të bëhej ndarja e pasurisë së babait.²³ Pat vështirësi të shumta sepse unë dhe Giuseppe duke qenë se ishim të mitur në moshë, duhej të përmbusheshin shumë detyrime dhe të bëheshin shumë shpenzime. Asgjë nuk i mungoi asaj leje. Kështu që familja ime u katandis me nënën time, vëllain tim Giuseppen, që desh që të jetonim të gjithë së bashku.²⁴ Gjyshja ime kishte vdekur disa vite më përpara.²⁵

Është e vërtetë që me atë ndarje mu hoq një peshë e rëndë dhe mu dha liri e plotë për të vazhduar studimet, por për t’ju bindur formaliteteve të ligjeve u deshën më shumë kohë dhe mua mu desh të ndiqja shkollat publike të Caltelnuovo²⁶ rreth Krishtlindjes së vitit 1828, kur po mbushja trembëdhjetë vjeç.²⁷

Studimet e bëra privatisht, hyrja në një shkollë me një mësues të ri, qenë për mua një hutim që mu desh gati të filloja gramatikën italiane nga e para për të ecur pastaj me atë latine. Për disa kohë çdo ditë shkoja nga shtëpia për në shkollën, por gjatë dimrit të ashpër për mua ishte e pamundur. Nga katër rrugë shko e eja bëheshin njëzet

²² *Prevosto*, tutull i dhënë famullitarëve. Në 1829 ishte prevosto i Castelnuovo don Bartolomie Dassano (1796-1854). Zëvendës famullitari në ato vite ishin dy: don Emanuele Virano (1797- 1834), që ishte edhe mësues në shkollën publike, e don Nicolao Noglia (1755-1838).

²³ Ndarja e pasurisë familjare u bë më 1830, kur Antonio bëhet në moshë madhore. Ai u martua me 22 mars 1831 me Anna Maria Rosso e qëndruan në shtëpinë në Becchi, ndërsa Margarita me të dy fëmijët e saj u transferua në shtëpinë në fermën e Sussambrino, ku Giuseppe punonte si punëtor. Do të ktheheshin për të banuar në Bechi në vjeshtën e 1839, në shtëpinë e re të ndërtuar nga Giuseppe.

²⁴ Giuseppe do të martohej me 9 mars 1833, me Maria Calosso (1813-1874).

²⁵ Gjyshja *Margarita Zucca* kishte vdekur me 11 shkurt 1826.

²⁶ Në atë kohë në shkollat e Castelnuovo ishin të ndara në seksione: shkolla fillore, e thënë ndryshe Komunale (e përbërë nga dy klasa, e shtata e madhe dhe e shtata e vogël), kishte rreth 70 nxënës të besuar një mësuesi të vetëm, dhe Latinita inferiore (përfshinë klasat e gjashta, të pesta dhe të katërta, të frekuentuara nga rreth 50 nxënës), edhe kjo ishte besuar një mësuesi të vetëm. Gjon Bosko regjistrohet në klasën e gjashtë.

²⁷ Donte të thoshte dhjetor 1830 (rreth dy javë pas vdekjes së don Calosso); Gjoni ishte 15 vjeç.

kilometër rrugë në ditë. Për këtë arsye më vendosën në një dhomë me qira me një njeri të ndershëm që quhej Roberto Giovanni me profesion rrobaqepës dhe një diletant i mirë i këngës gregoriane dhe i muzikës vokale. Dhe duke qenë se zëri më favorizonte u dhashë me gjithë zemër pas artit muzikor dhe në pak muaj munda të marr pjesë në orkestër dhe të bëja pjesët e detyrueshme me mjaft sukses. Edhe për më tepër duke dashur të zë me punë edhe kohën e lirë me ndonjë gjë, vendosa të pres e të qepi. Në një kohë të shkurtër qeshë i zoti të bëja pullat, të ktheja palën, të bëja tegel të thjeshtë e të dyfishtë. Mësova bile të pres dhe mbathjet, xhile, pantallona, jelekët dhe më duket se isha bërë një krye rrobaqepës i zoti.

Padroni im duke më parë të përparoj kaq mirë në zanatin e tij më bëri propozime mjaft të favorshme, në mënyrë që të qëndroja përfundimisht me të për të ushtruar zanatin. Por të ndryshme ishin pikëpamjet e mia: dëshiroja të ecja në studime. Për këtë arsye ndërsa për të evituar plogështinë merresha me shumë gjëra, bëja çdo sforco për të realizuar qëllimin kryesor.

Në atë vit jam përballur me ndonjë rrezik nga ana e disa shokëve. Donin të çonin që gjatë kohës së shkollës të luaja e duke qenë se unë i thosha se nuk kam para, më sugjeronin që t'ia vidhja padronin tim o nënës time. Një shok për të më bërë që të veprojmë më thoshte: “I dashuri im, është koha që të zgjohesh, duhet të mësosh të jetosh në botë. Kush mban sytë e mbyllur nuk sheh ku ecën. Hajt pra gjeji paratë dhe do të shijosh edhe ti kënaqësitë që provojnë shokët e tu”.

Më kujtohet që i kam dhanë këtë përgjigje: “Unë nuk arrij të kuptoj atë që doni të thoni, por nga fjalët tuaja më duket se po më këshilloni të luaj e të vjedh. Por ti a nuk thua çdo ditë lutjet, *i shtati urdhër të mos vjedhësh?* E pastaj kush vjedh është hajdut dhe hajdutët përfundojnë keq. Megjithatë nëna ime më do shumë e në se do ti kërkoja para për gjëra e duhura do ti mi jepte patjetër; me lejen e saj nuk kam bërë kurrë gjë të keqe, as që dua të filloj tani o ta shqetësoj. Në se shokët tuaj bëjnë këtë zanat janë të mbrapshtë. E pastaj e bëjnë vetë por dhe këshillojnë të tjerët, janë mashtrues dhe të ligj”.

Ky diskutim iu përcoll nga njëri tek tjetri e asnjëri nuk mi përsëri më këto propozime. Bile kjo përgjigje arriti edhe në veshin e profesorit që pas kësaj që i përzemërt më shumë me mua; u mur vesh edhe nga shumë prind dhe të afërm të këtyre të rinjve që për këtë arsye nxitnin fëmijët e tyre që të më zgjedhin për shok. Në këtë mënyrë unë munda me thjeshtësi të zgjedhja shokët që më donin dhe më bindeshin si atë të Morialdos.

Kështu që gjëra për mua filluan të merrnin një kthesë të mirë deri sa një ngjarje e re arriti të më trazojë. Mësuesi Don Virano,²⁸ profesori im, u emërua famullitar i Mondonio, dioqeza e Astit. Prandaj në prill të viti 1830²⁹ profesori i dashur do të merrte

²⁸ *Emanuele Virano* (1789-1834) ishte zëvendës famullitar e mësues.

²⁹ Don Virano mori në kujdes Mondonio në prill të 1831.

në zotërim famullinë e tij dhe u zëvendësua nga një që, nuk ishte i aftë në lëndën e tij, dhe gati hodhi në erë katër muaj mësim që kisha bërë.³⁰

5. Shkollat e Chieri – Mirësia e profesorëve – katër klasat e para të gramatikës

Mbas kaq kohë humbje më në fund u mor vendimi që të shkoja në Chieri³¹ ku do t'ju kushtoja seriozisht mësimi. Ishte viti 1830.³² Për kush është i rritur në pyje dhe ka parë pak vende të tjera, kur sheh një vend të vogël province provon një mbresë të fortë për çdo të re që sheh. Vendi ku do të rrija ishte shtëpia e një bashkëfshatare, Luçia Matta, vejtshë dhe me një fëmijë, që kishte shkuar në atë qytet për ta mbikëqyrur dhe për ta ruajtur.³³ Personi i parë që unë njoha qe prifti Don Eustachio Valimberti me dije të shumta dhe person i nderuar.³⁴ Ai më dhe shumë këshilla në mënyrë që të qëndroja larg rreziqeve, më ftoi që të shërbeja në meshë dhe kjo i dha mundësinë të në jepte

³⁰ Ndoshta e ka fjalën për ndihmësin e dytë të famullisë, don Nicolao Moglia, që në 1831 ishte 79 vjeç. Për do të shkruante famullitari në 1825: “Detyrën e zëvendës famullitari tani e bën meshtari Nicolao Moglia nga Moncucco, rrëfyet i aprovuar, që mbasi i ka shërbyer kësaj popullate për më shumë se 30 vjet me një shërbim të dobishëm përshpirtmërie, në cilësinë e të parit zëvendës famullitar, me hyrjen time në famullitë zgjedh me përparësi në detyrën e zëvendësit të dytë [.....]. Edhe pse ky meshtarë i denjë e të reduktuar detyrën vetës si zëvendësi i dytë kam dëshirë, që Zoti ta lërë në jetë edhe për shumë vite të tjera, dhe në shëndet për shumë arsye, por në mënyrë të veçantë sepse, është i palodhur gjatë ditëve të festave për të bërë rrëfimet, që janë një lirim i madh për famullitarin dhe lehtësim shumë i madh për popullatën”.

³¹ Chieri, qytet 16 km nga Torino. Siç shkruante Casalis në 1837, ishte “kryeqendra e çarkut [.....]; qendër e një komande ushtarake, e gjyqtarit të çarkut, e një delegati për reformën për studimet, dhe një përfaqësues i ndihmës mjekësisë; ka një zyrë ankesash; një zyrë për shpërndarjen e letrave; dy zyra lotarie, një magazinë për kripë e duhan, një stacion të karabinierë mbretëror të drejtuar nga një marshall kazerme, dhe një flamur garnizoni i drejtuar nga një zyrtar [.....]. Banorët e qytetit, bënë pjesë në dy famulli atë të Shën Marisë dhe të Shën Gjergjit, janë gjithsej 8.500; të tjerët rreth 5.000 janë të përfshirë në dy famulli [të rrethinave] të Santena e të Ajrali [.....]. Numërohen në Chieri më shumë se 70 meshtarë, 20 që i përkasin urdhrave rregulltarë [dominikan, oseranti minor, jezuit]”. Kishte shkolla bashkiake, kolegji të shkollave publike, me klasa të latinishtes të ultë dhe të latinishte së lartë, dhe një dy vjeçar filozofie. Në 1828 ishte hapur në Chieri i treti seminar madhor i dioqezës. Trojet për rreth qytetit, të punuara kryesisht në kopshtije, jepnin prodhime të mira, por ekonomia e qytetit bazohej mbi të gjitha mbi industrinë tekstile: “Punëtorë si kordatorë, filantë dhe thurës në numër janë rreth 4.000 vetë [.....]. 200 telajo numërohen në fabrikën Levi; 135 makineri të dimensioneve të ndryshme janë të destinuar për filaturën e pambukut [.....]. Në filaturat e ndryshme të mëndafshit, në sezonin e mbledhjes së çmueshme të fshikëzave, punojnë rreth 500 persona”.

³² Duhej të thoshte 1831. Viti shkollor fillonte me 1 nëntor, me treditëshin e ushtrimeve shpirtërore, dhe mbyllej për festën e shën Luigji Gonzaga (21 qershor).

³³ Lucia Pianta (1783-1851), e veja e Giuseppe Matta, me prejardhje nga Morialdo, njihje mirë nënën Margeritë, sepse shtëpia e të shoqit ishte në kufi me atë të Boskos. Ishte transferuar në Chieri për të ndjekur të birin, Giovanni Battista Matta (1809-1878), student pranë kolegjit të qytetit; ky do të bëhej kryetari i bashkisë së Castelnuovo nga 1863 deri në 1867.

³⁴ Në të vërtetë quhej Placido Michele Filipo Valimberti (1803-1848), ishte kapelan në kishën e Shën Guliemit (pak metër nga shtëpia e Lucia Matta) dhe mësues i klasës së pestë nga 1830 deri në 1839

gjithmonë ndonjë sugjerim të mirë. Ai në drejtoi tek prefekti i shkollave,³⁵ më bëri të njihesha dhe me të tjerë profesorë të mi. Duke qenë se studimet e bëra deri në atë kohë ishin pak nga të gjitha që do të thotë gati asgjë, kështu që qeshë i këshilluar të regjistrohem në klasën gjashtë³⁶, që sot do ti korrespondonte klasës përgatitore për vitin e parë gjimnaz.³⁷

Mësuesi i atëhershëm, T. Pugnetti,³⁸ edhe ai shumë i dashur në kujtimet e mia, më dha shumë dashuri. Merrej me mua në shkollë, në ftonte në shtëpinë e tij dhe i prekur nga mosha ime dhe nga vullneti im i mirë kur kursente asgjë që të mund të kisha përfitim.

Por mosha ime dhe shtati im më bënë të dukesh si një shtyllë e lartë në mes të shokëve të vegjë. I shqetësuar që të hiqesha nga ky pozicion, mbas dy muajsh në klasën e gjashtë, duke qenë se zura vendin e parë, u pranova në provimin dhe kalova në klasën e pestë. Hyra me shumë dëshirë në klasën e re, sepse shokët e klasës ishin pak më të mëdhenj e pastaj kisha si mësues të dashur don Valimberti. Mbasi kaluan edhe dy muaj të tjerë duke qenë se arritja të zija disa herë në vendin e parë në mësim, qeshë i pranuar me një mënyrë që nuk ishte e zakonshme në një tjetër provim dhe u pranova në klasën e katërt, që i korrespondon vitit të dytë të gjimnazit.

Në këtë klasë mësues ishte Giuseppe Cima,³⁹ njeri i rreptë për nga disiplina. Duke parë një nxënës të madh e të gjatë ti shfaqej në shkollën e tij në mes të vitit, duke qeshur, thotë në mes të shkollës: “Ky këtu o është një gomar i madh o është një talent i madh. Si thoni?”. Krejt i shastisur nga ai prezantim i rëndë: “Ndërmjet njërës e tjetrës,

³⁵ *Prefekti i shkollave (o i studimeve)*, sipas *Rregullores shkollore*, duhet të ishte në klerik; kjo detyrë zgjaste dy vjet dhe mund tu zgjidhte dy herë. Kishte për detyrë të mbante “vëzhgonte rregullin në shkolla, e në kongregata, dhe plotësimin e saktë të detyra për sa ishte e shkruar për profesorët dhe mësuesit, për të gjithë studentët e qytetit dhe për konviktet e tyre”. Kishte për detyrë të plotësonte regjistrin e studentëve, duke shënuar ditën e pranimit, vendin e qëndrimit në qytet, sjelljen brenda dhe jashtë klase dhe rezultatet e provimet. Ishte e detyra e tij të bënte pranimin e klasat e larta të studentëve. Kur Gjon Bosko arrin në Chieri kjo detyrë ishte e mbuluar nga dominikani Pio Eusebio Sibilla (nr. 1770), profesor i filozofisë, që dha dorëheqjen nga kjo detyrë në fund të vitit shkollor 1832-1833 sepse u emura prior provincial i dominikanë në Piemonte. Në vend të at Sibilës vendoset don Vincenzo Raviola (1768-1838), profesor në shkollat e Chierit deri në nëntor të 1800.

³⁶ *Klasa e gjashtë*: shkolla sabaude në atë kohë përfshinte dy klasa të shkollës fillore, e thënë dhe *shkolla komunale (e shtata e minore; e shtata e magjore)*, 3 klasa të *latinishtes inferiore, (e gjashta; e pesta; e katërta)*, 3 të *latinishtes superiore (e treta o gramatika, humanizëm, e retorika)*; e ndiqte një dyvjeçar i filozofisë (me klasat e fizikës dhe të logjikës).

³⁷ Këtu i referohet rregullores shkollore në fuqi në vitet në të cilat don Bosco shkruan *Kujtimet e Oratorit*. Shkolla piemonteze kishte qenë reformuar në 1859 nga ministri Gabrio Casati (1798-1873). *Arsimimi fillor* qe ndarë në dy shkallë, ajo inferiore (2 vite) dhe ajo superiore (2 vite); *arsimi sekondar klasik* u ndërtua në dy shkallë: *gjimnazi (5 vjet)* dhe *liceu (3 vjet)*; dhe *arsimi sekondar teknik* u nda në shkallë: *shkollat teknike (3 vjet)* dhe *instituti teknik (3 vjet)*.

³⁸ *Valeriano Giovanni Domenico Pugnetti* (1807-1868). Mësues kujdestar i klasës së gjashtë ishte don Gioacchino Vogliasso (1807-1854), i zëvendësuar për arsye shëndeti nga teologu Pugnetti. Emërimi i Pugnettit si profesor i së gjashtës do të formalizohej në shkurt të 1833. Titulli *teolog* në Piemonte ishte i rezervuar të diplomuarve në teologji pranë Universitetit Mretëror në Torino.

³⁹ *Vincenzo Giuseppe Cima* (1810-1854), lindur në Cambiano, nuk ishte meshtar, por seminarist tonsurato. Karriera e tij si mësues, që kishte filluar që 18 vjeç si mësues i së gjashtës (1828-1831), do të qojë që më vonë të mbulojë rolin e profesorit të së katërtës (1831-1837), të gramatikës (1837-1840), të humanizmit dhe retorikës (1840-1848).

iu përgjigja, jam një djalë i varfër që ka vullnet për të bërë detyrën e tij dhe të përparoj në studimet”.

I pëlqyen këto fjalë dhe me një mirësjellje të pazakontë shtoi: “Në se keni vullnetin e duhur, ju jeni në duar të mira, unë nuk do të lë pa punë. Merrni zemër e në se do të keni vështirësi, ma thoni qartë dhe unë do t’ju ndihmoj”. E falënderova me të gjithë zemër.

Kisha dy muaj në këtë klasë kur një ngjarje e vogël i bëri të gjithë të flisnin pak për mua. Një ditë një mësues po shpjegonte jetën e Agesilao i shkruar nga Cornelio Nepote.⁴⁰ Atë ditë e kisha harruar librin pa marrë dhe për t’ia fshehur mësuesit harresën time mbaja të hapur përpara Donato. Por shokëve i ra në sy kjo gjë. Njëri filloi, tjetri vazhdoi të qeshë duke cilësuar se shkolla ishte e parregullt.

“Çfarë keni, thotë mësuesi, çfarë keni? Të ma thoni menjëherë”. E duke qenë se sytë e të gjithëve ishin drejtuar nga unë, ai më urdhëroi që të bëja përmbledhjen dhe të përsërisja shpjegimin e tij. Atëherë u çova në këmbë dhe duke mbajtur akoma në duart e mia Donato përsërita tekstin përmendësh, përmbledhjen dhe shpjegimin. Shokët pothuajse instinktivisht më lavdëruan dhe rrahën shuplakat. Nuk mund të thuhet zemërimi që pat mësuesi; sepse sipas tij kjo ishte hera e parë, që nuk mundi të mbante rregullin në klasë. Ato thanë: “Bosko pat të hapur tij Donaton dhe lexoi e shpjegoi sikur të kishte gjithmonë përpara të hapur librin e Cornelios”.

Mësuesi në fakt e mori Donaton, më bëri të vazhdoi dhe dy periudha të tjera e pastaj më tha: “Për memorien tuaj të mirë ju fali harresën që keni bërë. Jeni me fat, por përdoreni vetëm për të mirë”.

Në përfundim të atij viti shkollor (1830-1831)⁴¹ pata nota të mira dhe u pranova në klasën e tretë gramatike ose ndryshe në të tretën gjimnaz.

6. Shokët – Shoqëria e gëzimit – Kristianë të ndryshëm

Në këto katër klasa më është dashur të mësoj mbi veten si të merrem vesh me shokët. Unë kisha bërë tre kategori shokësh: të mirët, indiferentët, të këqijtë. Këto të fundit i evitoja krejtësisht sapo i njihja; me indiferentët merresha për mirësjellje dhe për nevojë; me të mirët marrja familjaritet, në se unë do ti takoja dhe ato do të ishin tamam të tillë. Duke qenë se në këtë qytet unë nuk njihja njeri, kisha bërë një ligj familjarizimi me askënd. Megjithatë më është dashur të luftoj jo pak me atë të cilët nuk i njihja mirë.

⁴⁰ *Cornelio Nepote*, historik roman, autor i një vepre monumentale, *De viribus illustribus*, më e vjetra biografi e personazheve të së kaluarës, pjesa më e madhe të humbura. Por janë akoma jetët e 22 prijësve grek, aziatik dhe kartagjenas (ndër të cilët Agesilo, Alcibiade, Annibale, Temistocle) dhe ato të shkrymtarë latin Catone e Attico. Këto “jetë” ishin programi i studimeve të latinishtes inferiore.

⁴¹ Donte të thoshte 1831-1832.

Disa donin të më shihnin kur bëja teatër, të tjerët kur bëja ndonjë lojë, dikush tjetër kur shkoja të notoja.⁴² Dikush edhe vidhte fruta në kopshtije o në fusha.

Njëri prej tyre që aq i pafytyrë sa që më këshilloi ti vidhja zonjës së shtëpisë një send me vlerë vetëm sa për të blere karamele. Unë u lirova nga këto turmë të trishtueshme duke i ikur rreptësishtë shoqërisë së tyre, kur hap pas hapi më jepej mundësia ti zbuloja se kush ishin. E përgjithësisht të gjithëve i jepja këtë përgjigje se nëna ime më kishte besuar zonjës së shtëpisë dhe për respektin që unë kisha karshi saj nuk doja të shkoja në askund, dhe as të bëja diçka pa lejen e lartpërmendurës Lucia.

Kjo dëgjese e imja e qëndrueshme karshi Luçies gjatë kësaj kohë ishte në të mirë time, për këtë arsye me shumë kënaqësi më besoi djalin e saj të vetëm,⁴³ me natyrë shumë të gjallë, i dashurua pas lojës, i dhënë pak pas studimit. Ajo më dha detyrë që ta ndihmoja në përfundim të mësimave edhe se ai ishte një klasë përpara meje.

Unë u kujdesa si ta kisha vëlla. Me të mirë, me dhurata të vogla, me dëfrime shtëpiake e për më tepër duke e drejtuar nga praktikat fetare arrita ta bëja mjaft të butë, të bindur e studios sa që mbas gjashtë muajsh ishte bërë mjaft i mirë e këmbëngulës sa që bindi mësuesin e tij dhe mori vendi nderi në klasë. E ëma që mjaft e lumtur dhe si⁴⁴ çmim më fali të gjithë qiranë mujore.

Duke qenë se pastaj shokët, që donin të më tërhiqnin nëpër trazirat, ishin ata që nuk çanin kokën për detyrat, kështu që ato filluan të kërkojnë ndihmë nga unë, që të bëja bamirësi shkollore t'ia bëja o t'ia diktoja temat e mësimit. Kjo gjë nuk i pëlqeu mësuesit, sepse ajo bamirës false ushqente dembelizmin e tyre dhe ma ndaloi rreptësishtë këtë gjë. Atëherë u kapa mbas një rrugë më pak shkatërruese, vlen të thuhet se u mora që ti shpjegoj vështirësitë dhe ti ndihmoj ata që të kuptonin se çka është më e nevojshme. Në këtë mënyrë të gjithë kënaqeshin dhe të gjithë shokët më donin fort.

Ato filluan të vinin gjatë pushimit ndërmjet orëve, pastaj për të dëgjuar tregimet dhe për të bërë temat shkollore dhe më së fundi vinin pa pasur asnjë arsye si shokët e Morialdos e të Castelnuovo. Për ti vënë një emër këtyre bashkimeve vendosëm ta quanim Shoqëria e Gëzimit; një emër që i shkonte shumë, për këtë arsye ishte shumë e detyrueshme që gjithë secili të kërkonte ato libra, të bënte ato diskutime dhe ato lojëra që bënin të mundur të kontribuonin që të ishim të gëzuar; në të kundërtën ishte e ndaluar çdo gjë që sillte trishtim, në mënyrë të veçantë gjëra që i binin ndesh ligjeve të Zotit. Biles kush kishte mallkuar o përmendur e Zotit më kot ose kishte bërë biseda të këqija do të përjashtohej menjëherë nga shoqëria. I gjendur kështu në krye të një grupi shokësh, me një marrëveshje të përbashkët vumë si rregull: 1. Çdo anëtar i Shoqërisë të

⁴² Rregulloret shkollore në fuqi i ndalonin studentëve “notin, hyrjen në teatrot publik, në lojërat e shpejtësisë, vendosjen e maskave, të shkonin në balo me ftesa, në çdo lloj loje të lagjeve, në dyqanet e kafesë, të ngrënit dhe të pirit në hotele, në gjellëtore, të krijojnë rrethe, të diskutojnë duke pirë kafe, dhe të luajnë të teatrot shtëpiak pa lejen e Prefektit të studimit”; “Ato që do të gjinden duke kryer një vepër të ndaluar për herë të parë për dy muaj do ti hiqet çdo nderi i shkollës; për herë të dytë përjashtohen nga kalimin e klasën më lart në fund të vitit, dhe në mosrespektim të mëtejshëm përjashtimin nga shkolla”.

⁴³ Shënim në anë të don Boskos: “Matta Gio[vanni] Batt[ist]a i Castelnuovo nga Asti, prej shumë vitesh kryetar bashkie në vendin e tij, tashti shitës në dyqanin e të njëjtit vend”.

⁴⁴ Lexohet për çmim.

Gëzimit duhet të evitonte çdo bisedë, çdo veprim që nuk i përket një të krishteri të mirë; 2. Saktësia e përmbushjes së detyrave shkollore dhe e detyra fetare. Këto gjëra ndihmuan që të isha i përmendur për të mirë dhe në vitin 1832 unë isha i respektuar nga shokët e mi si kapiten i një ushtrie të vogël. Nga të gjitha anët unë isha i kërkuar për të bërë lojëra, të ndihmoja nxënësit në shtëpitë private bile dhe të jepja mësim o të ndihmoja për përsëritje në shtëpi. Me këtë mënyrë provania hyjnore më vinte në gjendja të siguroja sa ishte e nevojshme për rroba, objekte të shkollës dhe të tjera, pa i dhënë asnjë shqetësim familjes sime.

7. Shokë të mirë dhe ushtrime dhembshurie

Ndërmjet atyre që përbënin Shoqërinë e Gëzimit kam arritur të gjej disa me të vërtetë shembullor. Ndërmjet tyre⁴⁵ që meritojnë të jenë të përmendur janë Guglielmo Garigliano nga Poirino⁴⁶ dhe Paolo Braje nga Chieri.⁴⁷ Ato morën pjesë me shumë dëshirë në argëtimin me ndershmëri, por në atë mënyrë që gjëja e parë që duhej të bënin ishin detyrat e shkollës. Të dy donin përvujtshmërinë e dhembshurinë dhe vazhdimisht më jepnin këshilla të mira. Në të gjitha festat, mbas bashkësisë së kolegjit,⁴⁸ shkonim në kishën e Shën Antonit ku jezuitët bënin një katekizëm të mrekullueshëm,⁴⁹ dhe tregonin mjaft shembuj që edhe sot i mbaj mend.

Gjatë javës pastaj Shoqëria e Gëzimit mblidhej në shtëpinë e një anëtari për të folur për fenë. Në këtë mbledhje ndërhynte lirisht kush kishte dëshirë. Garigliano e Braje ishin dy më të përpiktit. Veprimtaria jonë bazohej në lojëra të këndshme, në diskutime të shenjta, në leximet fetare, në lutjet, për të dhënë këshilla të mira, dhe të vinim në dukje difektet tona që ndonjërit i kishin rënë në sy, o kishte dëgjuar nga të tjerët për ndonjë gjë. Pa e ditur atëherë vinim në praktikë mësimin madhor: *I lum kush ka një këshilltar*. Dhe atë të Pitagorës: *Në se nuk keni një mik që ju korrigjon defektet, paguani një armik që t'ju bëjë këtë shërbim*.

Përveç këtyre dëfrimeve miqësore shkonim të dëgjonim predikimet, shpesh rrëfeshim dhe për të bërë kungimin shenjtë. Këtu është mirë që t'ju kujtoj se në atë

⁴⁵ Lexohet....

⁴⁶ *Guglielmo Garigliano* (1819-1902) do të hyjë me Gjon Boskon në seminarin e Chierit; mbasi bëhet meshtar do ti kushtohet mësimdhënies në fillore dhe shërbimit baritor në famulli të ndryshme, duke e mbyllur jetën e vet si kapelan i Bashkëvvëllazërisë të Kryqit të Shenjtë të Poirinos. *Poirino*: vend bujqësor 5 km larg Chierit, pranë rrugës mbretërore që lidhte Torinon me Astin; në atë periudhë kishte rreth 6.500 banorë.

⁴⁷ *Paolo Vittorio Brajei* [o *Braja*] (1820-1832) vdes në të njëjtin vit për një infeksion polmonar.

⁴⁸ *Rregullorja e shkollave* parashikonte që çdo shkollë publike të kishte në një *Drejtues shpirtëror* dhe një kishë të vogël, në të cilën mblidheshin studentë përpara mësimin për të marrë pjesë në meshë dhe të dielave për funksionet fetare të mëngjesit dhe të pasdites. Këto grumbullime fetare quheshin *Bashkësi të studentëve*, emër që vinte nga Bashkësitë e vjetra mariane të kolegjeve të jezuetëve.

⁴⁹ I ngarkuar me mësimin e fesë të dielave në kishën e Shën Antonit ishte padër Isايا Carminati nga Bergamo (1798-1851), që në 1849 do të caktohet si profesor i së drejtës kishtare në Universitetin Gregorian.

kohë feja ishte pjesa themelore e edukimit. Një mësues që duke qeshur të thoshte një fjalë të ndyrë o jofetare menjëherë largohej nga detyra. Kur bënin kështu me mësuesit imagjinoni sa rreptësi përdorej karshi nxënësve të padisiplinuar o të mbrapshtë! Në mëngjesin e ditëve të festës ndiqej mesha shenjte; në fillim të shkollës recitohej me devotshmëri *Actiones* me *Ave Maria*.⁵⁰ Pastaj thoshim *Agimus* me *Ave Maria*.⁵¹

Në ditët e festës të gjithë nxënësit mblidheshin në kishën e bashkësisë. Ndërsa të rinjtë hynin për të bërë leximet shpirtërore, që ndiqej nga kënga e lutjesores së Zojës; pastaj mesha, pastaj shpjegimi i Ungjillit. Në darkë katekizmi, mbrëmësorja, mësimi. Secili duhej të afrohej sakramenteve të shenjta dhe për të ndaluar shpërfilljen e këtyre detyrave të rëndësishme, ishim të detyruar të paraqisnim një herë në muaj biletën e rrëfimit. Kush nuk kishte përmbushur këtë detyrë nuk pranohej në provimet në fund të vitit, edhe në se mund të ishte më i miri në studime. Kjo disiplinë e rreptë prodhonte efekte të mrekullueshme. Kalonin shumë vite pa u dëgjuar një mallkim o një bisedë e keqe. Nxënësit ishin të butë e të respektueshëm jo vetëm në periudhën e shkollës, por edhe në familje e tyre. Dhe ndodhte shpesh që në klasat me shumë nxënës në fund të vitit të gjithë të kalonin klasën. Në vitin e tretën, si në humanizëm si në retorikë të gjithë shokët e mi të klasës gjithmonë kaluan në vitin tjetër.

Aventura ime me më fat që zgjedhja e një rrëfyesi të përhershëm i cili ishte teologu Maloria kanonik i kolegjit të Chierit.⁵² Ai më priste gjithmonë me mirësi të madhe sa herë që shkoja tek ai. Biles më jepte zemër të rrëfeshesha dhe të komunikojta më shpesh. Ishte një gjë e radhë të gjeje dikë që të jepte zemër për frekuentimin e sakramenteve. Nuk më kujtohet që prej mësuesve të tjerë më kenë këshilluar një gjë të tillë. Kush shkonte të rrëfehej e të komunikonte më shumë se një herë në muaj gjykohej si më i moralshmi; dhe shumë rrëfyes nuk e lejonin. Unë pra ndihem borxhli ndaj rrëfyesi tim në se nuk u tërhoqa nga shokët në disa trazira që nxënësit e pa eksperiencë kanë pse ankohen në kolegjet e mëdha.

Gjatë këtyre dy viteve nuk i harrova asnjëherë shokët e mi të Morialdos. Mbjakta gjithmonë marrëdhënie me to dhe herë pas herë të enjteve i shkoja për vizitë. Në pushimet e vjeshtës sapo merrnin vesh që kisha ardhur në shtëpi vraponin të më takonin që nga larg dhe bënin gjithmonë një festa të veçantë. Edhe ndër to që futur Shoqëria e Gëzimit, në të cilën hynin ato që gjatë vitit kishin bërë shenjë me sjelljen e tyre të moralshme; në të kundërt, hiqeshin nga regjistri ato që ishin sjellë keq, në mënyrë të veçantë në se kishin mallkuar o kishin bërë biseda të këqija.

⁵⁰ *Actiones*: fillimi i një adhurimi të marrë nga *Sacramentario gregoriano*: “*Actiones nostras, quaesumus Domine, aspirando praeveni et adiuvando prosequere, ut cuncta nostra operatio a te temper incipiant et per te coepta finiatur*” (Frymëzoi veprimet tona, Zot, dhe shoqëroi me ndihmën tënde, sepse çdo aktivitet i joni të ketë në të fillimin tënd dhe në ty plotësimin tënd).

⁵¹ *Agimus*: fillimi i një lutje që thuhet në përfundim të punë o të bukës: “*Agimus tibi gratias, omnipotens Deus, pro universis beneficiis tuis. Qui vives et regnas in saecula saeculorum*” (Të falënderojmë, o Zot i gjithëpushtetshëm, për të gjitha të mirat tua. Ti që jeton e mbretëron në shekuj të shekujve. Amen).

⁵² *Giuseppe Maloria* (1802-1857), i diplomuar në teologji, kanonik i kolegjatës së Chierit. Do të jetë rrëfyes i Gjon Boskos edhe gjatë viteve të seminarit.

8. Humanizmi dhe retorika – Luigj Comollo

Mbasi kryen kurset e para të gjimnazit, kemi pasur një vizitë të Gjyqtarit të Reformës⁵³ i cili ishte avokati Prof. D. Giuseppe Gazzani, njeri shumë i zoti. Ai tregoi karshi meje shumë dashamirësi dhe unë kam ruajtur një kujtim shumë të mirë për të, dhe pas kësaj patëm gjithmonë në marrëdhënie miqësore. Ky prift i ndershëm jeton edhe tani në Moltedo e Sipërme pranë Oneljas vendi i tij dhe ndërmjet shumë veprave të bamirësisë ka krijuar një vend pa pagesë në kolegjin tonë të Alassios për një të ri që dëshiron të studiojë për tu bërë meshtar.

Ato provime u dhanë më shumë saktësi, prapëseprapë bashkënxënësit e mi që ishin dyzet e pesë në numër, të gjithë u pranuan në klasën superiore, që i korrespondon klasës së katër të gjimnazit. Unë rrezikova të mbetja në klasë sepse kisha bërë kopje të tjerëve. Në se u pranova i detyrohem mbrojtjes së të nderuarit mësuesit tim P. Giussiana, domenikan,⁵⁴ që mundi të më merrte një tjetër temë, dhe duke qenë se e bëra shumë mirë më pranuan për në klasën tjetër me nota maksimale.

Në atë kohë ishte një zakon i mirë që një nxënësi për nivel ti jepej një çmim nga bashkia që ishte një zbritje prej 12 franga nga taksa e detyrueshme shkollore⁵⁵. Për të marrë këtë çmim ishte e nevojshme të kishe notat maksimale në provimet dhe notat maksimale në moralin e sjelljes. Unë gjithmonë kam qenë i ndjekur gjithmonë nga fati dhe në çdo nivel e përfitova këtë ky çmim.

Atë vit kam humbur një prej shokëve të mi më të shtrenjtë. I riu Paolo Braje, shoku i dashur dhe i ngushtë, mbas një sëmundje të gjatë, model i vërtetë i dhëmbshurisë, i bindjes, i fesë së gjallë, vdiq me [10 korrik] në vitin [1832] duke shkuar tek Shën Luigjin, për të cilin qe besnik për të gjithë jetën e tij. I gjithë kolegji provoj keqardhje; të gjithë shokët e tij morën pjesë në varrim e tij. Dhe mjaft prej nesh për shumë kohë shkonim çdo ditë gjatë pushimeve të bënin kungimin e shenjtë, ti bënim lutje Zojës o thoshim rruzaren me shenjën e ditës për shpirt të shokut të tonë të vdekur. Megjithatë Zoti me mirësinë e tij ma zëvendësoi këtë humbje me një shok tjetër po aq i

⁵³ *Gjyqtari i Reformës*, institucion i vjetër piemontez në krye të arsimit të mesëm e universitar; “i riorganizuar nga Emanuele Filiberto me rastin e rihapjes në Torino të Universitetit të 1571, në shek. XVII qe objekt i masave të reja që përcaktonin edhe më tej kompetencat [.....] në fushën e “qeverisjes së mirë të Universitetit” dhe “drejtim i arsimimit publik në të gjithë Shtetin”, dhe nëpërmjet krijimit të Reformatoreve të provincave [.....]. Të tilla kompetenca shtrihen në kontrollin e drejtë për drejtë mbi mësuesat, mbi emërimin dhe vlerësimin e tyre, mbi përmbajtjen e mësimdhënies së tyre së bashku me ndërhyrjet relative të censurës. E ndërprerë në periudhë franceze dhe i rimarrë në vitin 1814, Gjyqtari i Reformës u shfuqizua përfundimisht në vitin 1847”.

⁵⁴ *Giacinto Giussiana* (1774-1844) nga kuvendi i Shën Domenico të Chierit, mësues i të pestës nga 1814 deri në 1817, pastaj profesor i klasës së tretë (e quajtur ndryshe edhe *gramatika*) për njëzet vjet, deri në vitin 1837, kur do të ja dorëzojë detyrën profesor Cimës.

⁵⁵ Në italisht kjo taks quhej *Minervale* term me të cilën quhej kjo taksë shkollore. Rregullorja për shkollat stabilizonte që paga e profesorëve të ishte në ngarkim të administratës civile dhe i lejonte qyteteve me pak të ardhura ekonomike që të kërkojë një taksë të ulët vjetore, “që paguhej si *minerale* që paguhej nga shkollat publike vetëm të latinishtes, por duke përjashtuar të varfrit dhe ata që shquheshin prej talentit, dhe prej sjelljes shëmbullore”.

virtutshëm, por më i shumë i dëgjuar për veprat e tija. Ai ishte Luigji Comollo,⁵⁶ për të cilin do të flas pas pak.

Përfundonte kështu viti i humanizmit dhe ia dola mjaft mirë në mësim, duke thënë se mësuesit e mi, në mënyrë të veçantë doktor Pietro Banaudi⁵⁷ më këshilluan⁵⁸ që të bëj provimin për filozofi, të cilin e kisha marrë; por duke qenë se më pëlqente studimi i letërsisë, gjykova që më mirë të vazhdoj shkollën rregullisht të bëja retorikë që është e barabartë me të pestën gjimnaz në vitin 1833-1834.⁵⁹ Pikërisht në këtë vit filluan dhe marrëdhëniet e mi me Comollon. Jeta e këtij shoku që çmuar e pata shkuar veçmas dhe çdo njëri mund ta lexojë sipas dëshirës;⁶⁰ por këtu po tregoj një fakt që ma ka bërë që ta njoh në mes të humanistëve.

Thuhej ndërmjet retorikëve që atë vit do të vinte në shkollë një nxënës i shenjtë, e thuhej se do të ishte nipi i famullitarit të Cinzanos,⁶¹ meshtar në moshë, por shumë i shquar për shenjtëri në jetë. Unë dëshiroja ta njihja, por nuk ia dija emrin. Dhe ja ajo që ndodhi⁶² që më mundësinë ta njihja. Nga ajo kohë ishte e përhapur loja e rrezikshme kaladibrance në mëngjes përpara se të fillonte mësimi në shkollë. Më të hallakaturit dhe ato që donin më pak mësimë ishin më energjikët dhe zakonisht më të përmendurit.

Shihej prej disa ditës një i ri modest rreth të pesëmbëdhjetave që, me ardhjen në kolegji, zinte vend dhe pa ia vënë veshin poteres që të tjerët bënin, fillonte të lexonte o të studionte. Një shok provokues i afrohet, e kap nga njëri krah, duke pretenduar që edhe ai të shkonte të luante kaladibrance.⁶³

- Nuk di, iu përgjigj tjetri krejt i përvuajtur dhe i turpëruar. Nuk di, nuk i kam bërë kurrë këto lojëra.

- Unë dua që ti të vish patjetër, përndryshe do të bëj që të vish nga shpullat e shqelmat.

- Mund të më mundësh aty ku ti je më i fortë, por unë nuk di, nuk mundem, nuk dua.....

Bashkënxënës i pasjellshmi dhe i mbrapsht e kapi për krahu, e përplasi dhe pastaj i dha dy shpulla që ushtuan në të gjithë shkollën. Duke parë këtë skenë më zinte gjaku në dej dhe prisja që i fyeri të bënte hakmarrjen e duhur; aq më tepër që i ofenduari ishte

⁵⁶ *Luigji Pietro Comollo*, i lindur në Cinzano me 4 prill 1817 nga Carlo, fshatar rrogat, e Giovanna Rosso; kishte 2 vëllezër e 3 motra.

⁵⁷ *Pietro Banaudi* (1802-1885), doktor në teologji, profesor i retorikës në Chieri gjatë vitit shkollor 1834-1834...

⁵⁸ Don Bosco shkruante më këshillonte....

⁵⁹ Duhet të thuhet 1834-1835.

⁶⁰ Është libri i parë i publikuar nga don Bosko: *Shënime historike mbi jetën e seminaristit Luigji Komolo që vdiq në seminarin e Kierit i admiruar nga të gjithë për virtutet e tija të veçanta, i shkrua nga një koleg i tij*. Dhjetë vet më vonë u bë një ribotim për serinë e *Lexime Katolike*, i përshtatur për nevojat e të rinjve.

⁶¹ *Famullitari i Cinzanos*: don Giuseppe Comollo (1768-1843). Cinzano është një komunë bujqësore e provincës dhe e dioqezës së Torinos, 19 km larg nga Chieri; në 1839 kishte rreth 660 banorë, pjesa më e madhe banonte në qendër, pranë kishës famullitare (kushtuar Shën Antonit Abat), dhe pjesa tjetër në dy lagjet atë të Aprës dhe të Torrasës.

⁶² Në vend të ja

⁶³ *Kaladibrance*: emri popullor i një loje, konsistonte në të shkapërcyerin, njëri pas tjetrit, mbi shpinën e viktimit së zgjedhur, deri sa ky i fundit rrëzohej për tokë nga pesha e shokëve.

shumë më i madh se tjetri në forcë dhe në moshë. Por pas kësaj ndodhi diçka e mrekullueshme, kur ky djalë i mirë me fytyrën të skuqur dhe gati me shenja nga shpullet, duke i lëshuar në shikim mëshirues shokut të keq i thotë vetëm kaq: “Në se kjo të mjafton për të qenë i kënaqur, shko në paqe, unë të kam falur tashmë”.

Ky akt heroik zgjoi në mua dëshirën që t’ia mësoja emrin dhe që ishte pikërisht Luigji Komolos nip i famullitarit të Çinsanos, për të cilin ishin dëgjuar shumë lavde. Nga ai moment pata e për gjithmonë për shok të ngushtë dhe mund të them se nga ai kam filluar të mësoj të jetoj si një i krishterë. Pata vendosur në të shumë mirëbesim, dhe ai në mua; njëri kishte nevojë për tjetrin. Unë për ndihmë shpirtërore, tjetri për ndihmë trupore. Si pasojë Komolo për druajtjen e tij nuk guxonte bile as të tentonte mbrojtjen kundër fyerjeve të këqijve, ndërsa unë ndër të gjithë shokët, edhe më të mëdhenj në moshë o në trup se unë, më kishin frikë; për kurajën dhe për forcën time. **Këtë kisha bërë në mënyrë të hapur përballë disave që kishin përçmuar dhe rrahur Komolon dhe një tjetër nxënës që quhej Antonio Kandelo që ishte dhe ai model i shpirtmirësisë. Unë desha të ndërhyja në favor të tyre, por nuk donte përkujdesjen.** Duke parë një ditë ato të keqtrajtuar të pafajshëm, “Të mjerët ju, i thasë me së të lartë; të mjerët ju në se do bëni edhe një herë keq këtyre”.

Një grup i rëndësishëm i më të gjatë dhe i më të pafytyrëve morën qëndrim të përbashkët mbrojtje dhe kërcënimi karshi meje, ndërsa dy shpulla tingëlluese ranë mbi fytyrën e Komolos. Në atë moment unë harrova veten dhe duke mos thirrur arsyen time, por forcën e ashpër, duke mos pasur nëpër duar as karrige dhe as shkop shtrëngova ndër duar një bashkënxënës nga shpatullat dhe e përdora si një shkop për të goditur kundërshtarët. Katër prej tyre ranë për tokë të tjerët ikën duke bërtitur e duke kërkuar mëshirë. Por çfarë? Në atë moment hyri mësuesi në shkollë e duke parë krahë e këmbë që tundeshin lart në mes të asaj shamate që dukej e një bote tjetër, filloi të bërtiste duke dhënë të shtyra sa djalhtas sa majtas. Stuhia ishte duke rënë mbi mua, por mbasi i tregova arsyen e kësaj asaj rrëmuje, desh që ta përsërisja atë skenë ose më mirë atë eksperiment force. Qeshi mësuesi, qeshën të gjithë nxënësit dhe gjithsecili duke u çuditur, nuk i vunë veshin më dënimit që unë kisha merituar.

Të tjera mësimë më jepte Comollo. “Shoku im, më tha sapo mundëm të flasim me njëri tjetrin, forca jote më tremb, por më beso, Zoti nuk ta jep për të masakruar shokët. Ai do që ne të jemi shokë, të falim dhe ti bëjmë mirë atyre që na bëjnë keq”.

Unë admiroja dashurinë e kolegut dhe duke e vënë veten në duart e tija, e lashë të më drejtonte ku donte ai. Dakord me shokun Garigliano shkuam së bashku të rrëfehemi, të kungohemi, të bënim meditim, leximet shpirtërore, vizitën në të Shejtueshimit Sakrament, të shërbenim në Meshën Shenjte. Dinte të ftonte me shumë mirësi, ëmbëlsi e me edukatë, sa që ishte e pamundur të refuzohej një ftesë nga ai.

Më kujtohet që një ditë duke biseduar me një shok kalova para një kishe pa e hequr kapelën nga koka. Tjetri më tha në mënyrë mjaft të sjellshme: “Gjoni im, ti je kaq i kujdesshëm të diskutosh me njerëzit, sa harron deri edhe shtëpinë e Zotit”.

9. Ibriku i kafesë dhe shitësi i pijeve – Dita e emrit – Një fatkeqësi

Duke thënë kështu diçka për gjërat e shkollës do të tregoj ngjarje të veçanta që mund të shërbejnë pushimi të këndshëm.

Në vitin e humanizmit kam ndryshuar vend banimi qoftë për të qenë më afër mësuesit tim, D. Banaudi, por dhe për t'ju bindur në miku të familjes që quhej Giovanni Pianta,⁶⁴ i cili vinte atë vit për të hapur një kafe në qytetin e Kierit. Ky strehim ishte sigurisht më i pasigurte, por duke qenë se isha midis të krishterëve të mirë dhe duke vazhduar marrëdhëniet me shokë model, kam mundur të eci përpara pa dëme morale. Përveç detyrave shkollore duke pasur mjaft kohë të lirë, një pjesë të kohë e zija duke lexuar klasikët italian o latin, dhe kohën tjetër duke bërë pije e ëmbëlsira. Në mes të atij viti unë isha në gjendje të përgatitja kafe, çokolatë; të njihja rregullat dhe masat për të bërë në përgjithësi karamelë, pijet, akulloret e pijet freskuese. Padroni im filloi të më linte në strehim pa qira dhe duke llogaritur avantazhin që mund t'ia jepja dyqanit të tij, më bëri oferta të leverdishme që të lija të gjitha punët tjera dhe ti kushtohesha vetëm atij zanat. Mirëpo unë bëja ato punë vetëm për dëfrim e pushim, por qëllimi im ishte të vazhdoja studimet.

Profesori im Banaudi ishte një model i vërtetë i mësimdhënies. Pa na dhënë asnjëherë qoftë edhe një dënim kishte mundur që ta kishin frikë dhe ta donin të gjithë nxënësit e tij. Ai i donte të gjithë si fëmijë dhe ato e donin si një baba të butë.

Për ti treguar dashurinë tonë vendosëm ti bëjmë një dhuratë për ditën e emrit të tij. Për këtë qëllim ramë dakord ti përgatisnim disa kompozime poetike dhe në prozë të bëra vetë, dhe ti siguronim disa dhurata që ne gjykonim që do të pëlqenin në mënyrë të veçantë.

Ajo festë doli madhështore, mësuesi mbeti shumë i kënaqur sa nuk thuhet dhe për të na e kthyer kënaqësinë e tij na ftoi të shkonim për drekë në fushë të hapur. Ajo ditë qe e mrekullueshme. Mësues dhe nxënës ishin bërë një zemër e vetme dhe gjithsecili mendonte si të shprehnin gëzimin e shpirtit. Përpara se të ktheheshim në qytet e Kierit mësuesi takoi një të huaj që iu desh ta shoqëronte duke na lënë vetëm për një pjesë të shkurtë të rrugës. Në atë moment na u afruan disa shokë të klasave më të mëdha që na ftuan të shkonim të laheshim në një vend që quhej *Burimi i kuq*, që ishte rreth një milje⁶⁵ larg Kierit. Unë me disa shokë kundërshtuam, por më kot. Mjaft kthyen me mua në shtëpi, të tjerët dëshiruan të shkonin të notonin. Sa mbyllje e trishtuar. Pak orë pas arritjes sonë në shtëpi, erdhi një shok, pastaj një tjetër të trembur duke vrapuar pa frymë për të na thënë: “Oh nuk dini se çfarë ka ndodhur, nuk e dini se çfarë ka ndodhur! Filipi N.⁶⁶ ai që nguli këmbë aq shumë që të shkonim të notonim, ka vdekur”.

- Si është e mundur, pyesnin të gjithë, ai ishte një notarë aq i famshëm!

⁶⁴ *Giovanni Pianta* ishte vëllai i Luçia Matta; me origjinë nga Morialdo, qëndroi në Kieri vetëm atë vit.

⁶⁵ *Milje*: masë e vjetër piemontese, “vlen 2 km e 469 m; por mbahet si për 2 km e gjysëm”.

⁶⁶ Me shumë mundësi ishte Filip Maurizio Camandona, 18 vjeç, vdiq me 18 maj 1834.

- Çfarë do të thotë kjo, vazhdoi tjetri, për të na dhënë kuraje që të zhyteshim në ujë, duke besuar në aftësisë së tij dhe duke mos i njohur vorbullat e rrezikshme të *Burimit të kuq*, u hodh i pari. Ne prisnim që të dilte sipër, por u zhgënjyem. Filluan të bërtasim, erdhën njerëz, u përdorën shumë mjete duke rrezikuar edhe të tjerët por veç mbas një ore e gjysmë ia dolën mbarë që të nxirrnin jashtë trupin e pajetë.

Një fatkeqësi e tillë shkaktoi tek të gjithë një trishtim të thellë; as atë vit as vit që pasoi (1834)⁶⁷ nuk u dëgjua nga askush që të kenë shprehur dëshirën për të bërë not. Para disa vitesh ndodhi që të takohem me disa nga këto shokë të vjetër, me të cilët kujtuam me një dhimbje të vërtetë fatkeqësinë që i ndodhi shokut tonë të pafat në vorbullën e *Burimit të kuq*.

10. Hebreu Gjona

Gjatë vitit të humanizmit, duke qëndruar në kafënë e mikut Giovanni Pianta pata mundësi të njihem me një të ri hebre që quhej Gjona.⁶⁸ Ai ishte rreth të tetëmbëdhjetat, me një pamje të bukur; kur këndonte kishte zë të radhë ndër më të bukurit. Luante mjaft mirë bilardo dhe duke qenë se ishim njohur në librarinë Elia, sapo arrinte në dyqan, pyeste për mua. Unë kisha shumë simpati për të, por edhe ai ishte i çmendur për miqësinë kundrejt meje. Çdo moment të lirë ai e kalonte në dhomën time; këndonim së bashku, e binim pianos, lexonim, duke dëgjuar me dëshirë mijra histori, që unë i tregoja. Një ditë i ndodh një grindje dhe rrahje që mund të kishte pasur pasoja të trishtueshme, me vrap ai vjen tek unë për të marrë një këshillë. “Në se ti, i dashur Gjona, të ishe i krishterë, i thashë, do të doja që të shkoje e të rrefeheshe; por kjo gjë për ty nuk është e mundur”.

- Por edhe ne, në se duam, shkojmë e rrëfehemi.
- Shkoni e rrëfehëni, por rrëfyeni juaj nuk është i detyruar të mbajë sekretin, nuk ka fuqi të shlyej mëkatet, as nuk mundet të administrojë asnjë sakrament.
- Në se mund të më shoqërosh, unë do të shkoja të rrëfehëni tek një prift.
- Unë mund të shoqëroj, por duhet shumë përgatitje.
- Çfarë përgatitje?
- Ta dish që rrëfimi shlyen mëkatet e bëra mbas pagëzimit; për këtë arsye në se ti dëshiron të marrësh ndonjë sakrament është e nevojshme që para çdo gjëje tjetër ti duhet të marrësh pagëzimit.
- Çfarë duhet të bëj për të marrë pagëzimin?
- Të mësosh besimin e krishterë, të besosh në Jesu Krishtin Zot i vërtetë e njeri i vërtetë. Kur të bësh këtë ti mund të marrësh pagëzimin.

⁶⁷ Duhej të thuhet 1835.

⁶⁸ *Gjona*: pseudonimi i Gjakobe Levi (1816-1870), i biri i Lazaros dhe i Bela Pavia. Dikush thotë se ishte i vëllai i industrialistit të tekstit David Levi, *maire adjoint* i Kierit në periudhën e Napoleonit, por nuk duket e mundur për arsye të regjistrimit të gjendjes civile: “Gjakobe Levi i biri i Lazrit (vëllai i maire adjoint David) i pagëzuar në 1834”.

- Çfarë avantazhi do të më japë pagëzimi?
- Pagëzimi të shlyen mëkatet origjinal dhe mëkatet aktuale, të hap rrugën për marrjen e të gjithë sakramenteve të tjera, të bën në fund të fundit bir të Zotit dhe trashëgimtar të parajsës.
- Ne hebrenjtë nuk mund të shpëtojnë?
- Jo, i dashur Gjona, mbas ardhjes së Jezu Krishtit hebrenjtë nuk mund të shpëtojnë më pa besuar në Të.
- Në se nëna ime e merr vesh që unë jam bërë i krishterë, mjerë unë!
- Mos ki frikë, Zoti është zotërues i zemra tona e në se ai të thërret për tu bërë i krishterë, do të bëjë të mundur që nëna jote do të jetë e kënaqur o do të kujdeset për shpirtin tënd.
- Por ti që do të mirën time, po të ishte në vendin tim, çfarë do të kishe bërë?
- Do të filloja të përgatitem në fenë e krishterë, ndërkohë Zoti do të më hapë rrugën se çfarë do të bësh në të ardhmen. Për këtë qëllim merr katekizmin e vogël dhe fillo të mësosh. Lutu Zotit që të shndrisë dhe të bëjë të njohë të vërtetën.

Nga ajo ditë filloi ta ketë shumë për zemër besimin e krishterë. Vinte në kafe dhe sa bënte një lojë bilardo më kërkonte mua për të diskutuar mbi fenë dhe katekizmin. Në pak muaj mësoi të bënte shenjën e *Kryqit të Shenjtë, Ati ynë, Të falem Mari, Besoj* dhe të tjera të vërteta kryesore të fesë. Ai ishte shumë i kënaqur dhe çdo ditë bëhej më i mirë në të folur dhe në punuar.

Ai kishte humbur të atin kur ishte fëmijë i vogël, e ëma që quhej Rakele kishte dëgjuar ndonjë fjalë, por nuk dinte akoma asgjë. Kjo u zbulua në këtë mënyrë: një ditë duke i rregulluar shtratin ajo kishte gjetur librin e katekizmit që i biri kishte harruar nga pakujdesia ndërmjet këllëfit dhe dyshekut. Ajo filloi të bërtiste me të madhe nëpër shtëpi, çoi librin e katekizmit tek rabini dhe duke dyshuar për atë që në fakt ishte, vrapoi me shumë ngut tek nxënësi Bosko, për të cilin i biri i saj i kishte folur shpesh herë. Imagjinoni në mendje një lloj shëmtie dhe do të keni idenë e nënës së Gjona. Ishte e verbër nga njëri sy, shurdhe nga të dy veshët; me hundë të madhe; pothuajse pa dhëmbë, buzë të trasha, gojë të madhe, mjekër të gjatë e të mprehtë, zë të ngjashëm me hungërimën e një mëzi. Hebrenjtë guxonin ta thërrisnin me e ermin e magjistaria *Lili [Lilith]*, me një emër të tillë ato quanin gjënë më të shëmtuar të kombit të tyre. Shfaqja e saj më trembi dhe pa më dhënë kohë që ta merrja veten filloi të flasë kështu: “Për besë po të bëj be, ju e keni gabim; ju, po ju më keni shkatërruar Gjonën tim; e çnderuar përpara njerëzve unë nuk di se çfarë do të bëhet me të. Kam frikë se do të më bëhet i krishterë dhe ju do të jeni shkaku”.

Atë herë kuptova kush ishte dhe për kë po fliste dhe me shumë qetësi i përgjigjem që ajo duhet të ishte e kënaqur dhe të falënderonte atë që po i bënte mirë të birit.

- Çfarë e mire është kjo që thua? A thua është mirë që ta bësh ta mohojë fenë e vet?
- Qetësohuni, zonjë e nderuar, i thashë, dhe dëgjo: unë nuk kam kërkuar Gjonën tuaj, por jemi takuar në dyqanin e librashitësit Elia. Jemi bërë miq pa e ditur arsyen. Ai

është shumë i përzemërt me mua; unë e dua shumë, dhe si shok i vërtetë dëshiroj që ai të shpëtojë shpirtin dhe që të mund të njohë ato fe jashtë të cilës askush nuk mund të shpëtojë. Shiko, o nëna e Gjonas, se unë i kam dhënë një libër djalit tuaj duke i thënë që vetëm të mësojë për fenë dhe në se ai do të bëhet i krishterë të mos braktisë fenë hebraike, por ta përsosë.

- Në se fatkeqësisht ai do të bëhet i krishterë atij i duhet të braktisë profetët tanë, sepse të krishterët nuk besojnë në Abrahamin, Isakun, Gjakobin, tek Moisiu dhe as tek profetët.

- Përkundrazi ne besojmë në të gjithë patriarkët e shenjtë dhe të gjithë profetët e Biblës. Shkrimet e tyre, thëniet e tyre, profecitë e tyre formojnë themelin e besimit të krishterë.

- Po të ishte këtu rabini jonë, ai do të dinte si të përgjigjej, unë nuk di as *Misna* e as *Gemara* (janë dy pjesë të *Talmud*).⁶⁹ Por çfarë do të bëhet me Gjonën tim të shkretë?

Tha këto fjalë dhe iku. Do të shkonte gjatë po t'ju referoja sulmeve që më janë bërë shpesh herë nga e ëma, nga rabini, nga të afërmit e Gjonas. S'pat kërcënimi, as dhunë që nuk u përdor kundër guximit të një të riut. Ai vuajti shumë dhe vazhdoi të mësonte në fe. Duke qenë se në familje nuk kishte të sigurt jetën, u detyrua kështu që të largohej nga shtëpia dhe të jetonte pothuajse duke lypur. Por ama shumica e ndihmonin dhe që çdo gjë të ecte me maturinë e duhur, e rekomandova nxënësit tim tek një prift i ditur, që u kujdes për të si at. Atëherë më të vërtetë u mësuar në besim, duke u treguar i paduruar për tu bërë i krishterë, u bë një solemnit⁷⁰ që shërbej si shembull i mirë për të gjithë seminaristët dhe si nxitje për hebrenjtë e tjerë, të cilët më vonë shumë prej tyre përqaftuan fenë e krishterë.

Nuni dhe nuna qenë Karlo dhe Otavia bashkëshortët Bertinetti,⁷¹ të cilët plotësuan për qe e nevojshme për fillestarin që, i bërë i krishterë, arriti të fitojë bukën e jetës me punën e tij të ndershme. Emri i tij i krishterë qe Luigj.

⁶⁹ *Misna* [*Mishna*]: një ndër vepra kryesore të judaizmit hebraik; një shkrim i redaktuar nga tradita gojore hebraike, që reflekton debatet e të diturve dhe të shkollave rabinike nga viti 70 deri në vitin 200 mbas Krishtit mbi aplikimin e ligjeve (*Torah*) në jetën e përditshme. *Gemara*, në fakt, është pjesë e *Talmud* që përmban komentet dhe interpretimet e *Mishna*; redaktohet në tre shekujt që pasuan. Të tilla praktika interpretuese gjenden historikisht në zemër të identiteti hebraik: "Torah është qendra e ndërthurjes së referimit, të shpjegimeve dhe e debateve hermeneutike që i japin forcë organike jetës së përditshme dhe historike të bashkësisë, që mund të përcaktohet si një traditë e koncentrike e literaturës. *Gemara*, komenti mbi *Mishna*, përmbledhja e ligjeve dhe përshkrimet gojore që formojnë *Talmud* dhe *Midrash*, vlen të thuhet pjesa e komenteve që trajton më shumë veçanti të interpretimit të kanunit biblik, shprehin dhe gjallërojnë përbërjen e hebraizmit".

⁷⁰ Pagëzimi u celebrua në famullinë e Shenjtës Maria della Scala me 10 gusht 1834. Ngjarja është e treguar në kronikat e Bashkëvëllazërisë të Disiplinuarve të Shpirtit të Shenjtë, që kishte për detyrë të asistonte katekumenët: "Viti 1834 qe një vit për tu kujtuar për Bashkëvëllazërinë, për pagëzimin solemnit të dhënë nga Kolegjata hebreut Gjakobe Levi i Lazrit".

⁷¹ Nga rregjistrat e pagëzimit dimë se Ottavia Maria Bertinetti qe nuna, ndërsa nuni qe Giacinto Balmida. Neofita, në nderim të nunëve, mori emrin e Luigj Giacinto Ottavio Maria dhe mbiemrin Bolmida, sepse, duke qenëse nuk kishte moshën e pjekurisë (që në atë kohë ishte 21 vjeç) u adoptua nga nuni.

11. Lojërat – Lojërat e shpejtësisë – Magjia – Shfajësimi

Në mes të studimeve të mia dhe dëfrimeve të ndryshme, siç janë kënga, muzika, mbajtja e fjalimeve, teatro të vegjël, në të cilat merrja pjesë me gjithë zemër, gjithashtu kisha filluar të mësoj dhe lojëra të tjera të ndryshme. Me letra, taroki, me lëmshe, rrasa, paterica, kërcime, vrapime, ishin të gjitha dëfrime që të kënaqnin shumë, në të cilat, edhe pse nuk isha më i miri, nuk isha sigurisht më i parëndësishmi. Pjesën më të madhe i kisha mësuar në Morialdo, të tjerat në Kieri, dhe në se në livadhet e Morialdos kisha qenë një nxënës i vogël, në atë vit isha bërë një mjeshtër i paarritshëm. Kjo shkaktonte shumë habi sepse në atë epokë lojëra të tilla duke qenë se ishin pak të njohura, dukeshin si gjëra të një bote tjetër. Por çfarë mund të themi për lojërat e shpejtësisë?

Shpesh jepja shfaqje publike dhe private. Duke qenë se kujtesa më favorizonte shumë, arrija të mbaja përmendësh pjesën të madhe të klasikëve në mënyrë të veçantë të poetëve. Dante, Petrarca, Tasso, Parini, Monti dhe të tjerë që më ishin aq shumë familjarë për mua sa që mund ti përdorja sipas dëshirës sikur të ishin një rrobë e imja. Për këtë arsye gjërat më vinin aq lehtë sa që arrija të trajtoja çfarë do argumenti. Gjatë atyre argëtimeve, në ato shfaqje herë këndoja, herë i bija veglave o krijoja vjersha, që i gjykonin si kryevepra, por që në të vërtetë nuk ishin tjetër veç se fragmente autorësh që i kishin përshtatur argumenteve që paraqisja. Për këtë motiv nuk i kam dhënë kurrë krijimet e mia të tjerëve; dhe ndonjërin që pata shkruar jam kujdesur që ta djeg.

Ndërsa habia për lojërat e shpejtësisë rritej. Të shohësh që nga një kupë të dalin një mijë topa të gjithë më të mëdhenj se kupa; që nga xhepi të nxirren jashtë një mijë vezë, ishin gjëra që bënin të mbeteshe pamend. Kur pastaj shihnin të mblidhja topthat nga maja e hundës së shikuesve; merrni me mend paratë nga qeskat e të tjerëve; kur me një të prekur të lehtë të gishtave ktheheshin në pluhur monedhat të çfarë do lloj metali apo kur bëja që të shfaqeshin përpara dëgjuesve gjëra të frikshme o pa kokë, atëherë disa filluan të binden që unë isha një magjistar dhe që arrija të bëra gjëra të tilla veç me ndërhyrjen e ndonjë dreqi.

Rritej besimi i pronarit të shtëpisë sime që quhej Tomazo Kumino.⁷² Ishte një i krishterë i zjarrtë, që donte shumë shakatë dhe unë dija të përfitoja nga karakteri i tij dhe arrija ti bëja shaka gjithë fare. Një ditë me shumë kujdes kishte përgatitur pulë në xhelatinë për t'ia dhuruar qiraxhive të tij për ditën e emrit. Solli në tavolinë pjatancën, por mbasi hoqi kapakun, kërceu jashtë një gjel që fluturoi duke kakarisur sa mundte. Një herë tjetër na dha një kusi makaronash, e duke qenë se i kishte lënë të zienin për një kohë të gjatë, kur desh ti hidhte në pjatë nuk pat tjetër gjë veç se krunde të thata. Shumë herë mbushte shishen e verës dhe kur donte ta hidhte në gotë, ishte veç uji i kthjellët. Pastaj kur doja të pija ujë, gjeja gotën plot me verë. Reçeli i vendosur mbi rrishtat e bukës; monedhat në portofol ishin shndërruar në copëza llamarine të pavlerë; kapela e

⁷² Tomazo Kumino (1765-1840), lindur në Andezeno, rrobaqepës, strehonte në shtëpinë e tij disa studentë; tek ai banoi edhe Gjuzepe Kafaso gjatë vitin shkollor 1827-1828. Gjon Bosko banoi në Kumino gjatë vitit shkollor 1834-1835.

shndërruar në kapuç; arra e lajthia të shndërruara në kokrra të mbushura me zhavorr, ishin gjëra mjaft të shpeshta.

Tomasi i mirë nuk dinte se çfarë të thoshte më. Njerëzit, thoshin me njeri-tjetrin se, nuk duhej të bëheshin këto gjëra; Zoti nuk humb kohë me këto gjëra të pavlerë; pra ishte djalli që i bënte këto gjëra. Duke mos guxuar të fliste me atë të shtëpisë, u këshillua me një prift të afërm të tij, Don Betinetti.⁷³ Duke parë se kjo ishte thjeshtë në *magji e bardhë* në atë çfarë u bënte në ato lojëra, vendosi ti referohej kjo gjë delegatit të shkollave që në atë kohë një përgjegjës kishtar, kanoniku Burzio,⁷⁴ dekan dhe ndihmës famullitar i katedrales. Ky ishte një person shumë i ditur, besimtar dhe i kujdesshëm; dhe pa i thënë kujt asnjë fjalë më kërkon *ad audiendum verbum*.⁷⁵ Arrita në shtëpinë e tij në çastin që po lexonte librin e lutjeve dhe duke më parë me një buzëqeshje më bëri me kokë të prisja pak. Në fund më tha ta ndiqja në një dhomë dhe aty me fjalë të sjellshme, por me pamje të rreptë filloi të më pyes kështu: “I dashuri im, unë jam shumë i kënaqur me studimin tënd dhe me sjelljen që ke pasur deri tani; por tashti tregohen për ty shumë gjëra.... Më thonë që ti njeh mendimet e të tjerëve, gjen sa para kanë në qese të tjerët, bën të shihet e bardhë atë që është e zezë. Njeh gjërat nga larg e të ngjashme. Kjo bën të flasin shumë për ty dhe disa kanë arritur të dyshojnë se ti përdorë magjinë dhe për këtë në këto veprime ndodhet shpirti i Djallit. Më thuaj pra: kush të ka mësuar në këto shkenca, ku i ke mësuar? Më thuaj çdo gjë në mirëbesim; të siguroj që nuk do ti përdor, por vetëm për të mirën tënde”.

Pa u shqetësuar i kërkoja pesë minuta kohë që të përgjigjesha dhe e ftova të më thotë orën e saktë. Ndërsa ai vendosi dorën në xhep nuk gjet orën e tij. “Në se nuk e keni orën, shtova, më jepni një monedhë të vogël”. Kërkoj në çantën e tij, por nuk gjet portofolin. “Mashtroes, filloi të më thotë krejt i zëmëruar; ose ti je shërbëtor i djallit ose djalli të shërben ty. Ti më ke marrë portofolin e orën. Unë nuk mund të heshti, jam i detyruar të denoncoj e nuk e di se si mbahem për të dhënë një dru të mirë”. Por duke më parë të qetë e të buzëqeshur duket se u qetësua dhe rifilloi: “Ti marrim gjërat në mënyrë paqësore. Mi shpjego këto mistere. Si u bë e mundur që portofoli im dhe ora ime dolën nga çanta ime pa e ndjerë unë? Ku kanë shkuar këto gjëra?”.

- Zoti ndimësfamullitar, fillova të flas respektueshëm, unë të shpjegoj çdo gjë me pak fjalë. Qëndron e gjitha në shkathtësinë e duarve, inteligjencë e fituar ose gjëra të përgatitura.

- Çfarë inteligjence duhet për orën e për portofolin tim?

⁷³ *Luigi Bertinetti* (1794-1848), prift, vëlla i Carlos.

⁷⁴ *Massimo Giuseppe Burzio* (1777-1847), i diplomuar në Teologji, qe kanonik ndihmës famullitar i Kolegjit të S. Maria della Scala nga 1833 deri në vdekje. Ishte autoriteti me i madh kishtar në Kieri dhe kishte dhe detyrën e Delegatit të Reformës, pra përfaqësuesi Gjykatës së Reformës për mbikëqyrjen e shkollave të qytetit. Lexojmë në rregulloret shkollore: “Do të jetë ky detyra e mbikëqyrësit, në mënyrë që në të gjitha shkollat fillore, o të latinishtes, o në shtëpitë ku rrinë nxënësit, o në konvikte, që ndodhen në zonën e besuar, të vëzhgojnë rregullat që janë përcaktuar për to, e mos të bëjnë thyerje të tyre”.

⁷⁵ *Ad audiendum verbum*: shprehje e përdorur për të treguar një bashkëbisedim privat për sqarim me një superior.

- Ju shpjegoj çdo gjë shkurt. Kur arrita në shtëpinë tuaj ju po i jepni diçka një nevojtar, dhe vendosët çantën mbi gjunjzuesin. Duke shkuar pastaj nga kjo dhomë në tjetrën harruat orën mbi këtë tavolinë. Unë fsheha njëërën dhe tjetrën, dhe ju menduat se i keni me vete këto sende, ndërsa ishin poshtë kësaj tende.

Thashë këto fjalë dhe ngrita tendën ku ndodheshin të dyja sendet të besuar se djalli i kishte çuar diku tjetër.

Qeshi jo pak prifti i mirë; më bëri të bëj disa lojëra të tjera, dhe të njohë mënyrën se si gjërat shfaqeshin dhe zhdukeshin, iu bë qejfi shumë, më bëri një dhuratë të vogël dhe në fund më tha kështu: “Shko e thuaji të gjithë shokëve të tu se *ignorantia est magistra admirationis*”.⁷⁶

12. Vrapimi – Kërcimi – Shkopi magjik – Maja e pemës

Duke u shfajësuar se në argëtimet e mija nuk kishte magji të bardhë fillova përsëri të mbledh shokët për tu dëfryer dhe argëtuar si përpara. Në atë kohë disa lavdëronin shumë një akrobat që kishte dhënë një shfaqje në publik se përshkonte me vrap qytetin e Kieri nga njëra anë në tjetrën për dy minuta e gjysmë, që ishte koha që i duhej trenit me shpejtësi të madhe të bënte një rrugë të tillë.

Duke mos pasur kujdes për pasojat e fjalëve të mia pata thënë që unë do të isha matur me atë akrobat. Një shok pa menduar fare i referon këtë gjë akrobatit dhe ja si iu futa kësaj gare: një student sfidon një vrapues profesionist! Vendi i zgjedhur ishte rruga e Portës Torineze.⁷⁷

Basti ishte 20 franga. Duke mos e pasur këtë shumë, shumë miq që i përkisnin Shoqërisë së Gëzimit, më ndihmuan. Një mori njerëzish morën pjesë. Filloi⁷⁸ vrapimi dhe kundërshtari im fitoi disa hapa: por shpejt fitova terren dhe e lashë aq mbrapa sa në mes të garës u ndal, duke më dhënë ndeshjen e fituar.

- Të sfidoj në kërcim, në tha, por dua të vë bast 40 franga, dhe më shumë në se ke dëshirë.

Pranova sfidën dhe i përkiste atij të zgjidhte vendin, ai vendosi që kërcim duhej të zhvillohej kundrejt parmaku të një ure. Ai kërcëu i pari dhe vendosi këmbën shumë afër një muri të vogël, duke qenë se më tej nuk ishte e mundur të kërcëhej. Në këtë mënyrë unë mund të humbja, por jo të fitoja. Por puna ime sistematike më erdh në ndihmë. Bëra të njëjtin kërcim, por duke mbështetur duart në mbi parmakun e urës duke e zgjatur kërcimin përtej murit dhe në të njëjtin kanal. Duartrokitje të përgjithshme.

- Dua akoma të bëj në sfidë. Zgjedh cilën di lojë shkathtësie që do ti.

⁷⁶ *Ignorantia est magistra admirationis*: citat i marrë nga Rrëfimet e shën Agostinit/

⁷⁷ *Porta Torinese* (ndryshe edhe *Vajro*) ishte emri i një porte të lashtë në muret e Kierit që hapej përballë një rruge të gjerë plot me pemë drejtë Torinos. Ndërtimin mesjetar e shembën në vitin 1850.

⁷⁸ Lexohet

Pranova dhe zgjedha lojën e shkopit magjik me një bast prej 80 franga. Mora ndërkohë një shkop, dhe në njërën anë vendosa një kapele, pastaj vendosa anën tjetër mbi pëllëmbën e dorës. Pastaj pa e prekur me dorën tjetër e bëra të hidhej mbi majën e gishtit të vogël, në gishtin e unazës, në gishtin e mesit, në gishtin tregues, e në gishtin e madh; pastaj mbi grushin e dorës, mbi bërryl, mbi shpatull, mbi mjekër, mbi buzë, mbi hundë, mbi ballë. Pras kësaj duke bërë të njëjtë gjë eca për rreth mbi pëllëmbën e dorës.

- Nuk kam frikë se humbas, më thotë kundërshtari, kjo është loja ime e preferuar.

Mori po të njëjtin shkop dhe me një shkathtësi të mrekullueshme e bëri të ecte deri tek buzët ku, duke pasur paksa hundën e gjatë, u përplas dhe humbi ekuilibrin iu desh ta kapte me dorë që të mos e lejonte të binte në tokë.

Ai njeri i mjerë duke parë pasurinë që po i shkonte në fund gati si i tërbuar bërtiti me të madhe: “Më mirë një tjetër poshtërim, por jo këtë që të fitojë një nxënës. Kam akoma 100 franga dhe këto i vë bast dhe do ti fitojë ai i cili do të vendosi këmbët sa më afër maje të kësaj peme”, ishte duke folur për pemën e vidhit që ishte në krah të rrugës. Pranuan edhe këtë herë, biles ishim të kënaqur që ai të fitonte me qenë se ndjenim keqardhje dhe nuk donim të rrënonim.

Ai u ngjit i pari mbi pemë dhe i vendosi këmbë në një lartësi të tillë sa, po të ishte ngjitur edhe pak më lart, sa që pema do të ishte përkulur duke lëshuar për tokë atë që po ngjitej. Të gjithë thoshnin që nuk ishte e mundur të ngjitej më lart se aq në pemë. Unë bëra provën time. U ngjita deri në një farë lartësi pa e përkulur pemën, pastaj duke u mbajtur me duar në pemë ngrita trupin dhe çova këmbët rreth një metër përmbi lartësinë e kundërshtarit tim.

Askush nuk mund të përshkruaj duartrokitjet e asaj more njerëzish, gëzimin e miqve të mi, hidhërimin e akrobatit dhe krenarinë time, që kisha dalë fitimtar, jo kundër shokëve të mi, por kundër një krye akrobati? Në mes të këtij rrënimi megjithatë deshëm ti japim një ngushëllim. Hoqa mëshirën nga trishtimit i të shkretit e i thamë se ne do t’ia kthenim paratë e tija vetëm në se pranonte e një kusht, që ai të na paguante një drekë në hotelin tek Moretto.⁷⁹ Pranoi me një mirënjohje të madhe. I thamë se ishim 25 vetë, se kaq ishte numri i ndjekësve të mi. Dreka kushtoi 25 franga, kështu që iu kthyen 215 franga.

Ajo që me të vërtetë një enjte e hareshme. Unë u mbulova me lavdinë se për nga shkathtësia ia kisha kaluar një akrobati. Shokët ishin shumë të kënaqur për dëfrimin që bënë e aq më tepër, biles sa nuk thuhet, për drekën. I kënaqur duhej të ishte edhe akrobati që kishte pothuajse të gjithë paratë e tija, dhe ai mbet i kënaqur me drekën. Duke u ndarë ai na falënderoi të gjithëve duke na thënë: “Duke më kthyer këto para ju keni penguar shkatërrimin tim. Ju falënderoj me gjithë zemër. Ruaj për ju një kujtim të mirë, por nuk do të vë më baste me nxënësit”.

⁷⁹ Hoteli i *Mullettos* gjendet në Piacca Armi, sot Piacca Kavour, përgjatë rrugës kryesore.

13. Studimi i klasikëve

Duke më parë që kaloja kohë me argëtimet, ju do të mendoni se për këtë arsye linja mbas dore studimin. Nuk ju fsheh që mund të kisha studiuar më shumë, por besoj se vëmendja ndaj shkollës më mjaftonte të mësoja sa ishte e nevojshme. Aq më tepër që në atë kohë unë nuk bëja dallim midis të lexuarit dhe të studiuarit dhe më lehtësi mundja të përsëritja me një të lexuar o me një të dëgjuar atë që kisha mësuar. Për më tepër duke qenë se nëna ime më kishte mësuar të flija mjaft pak, mundja të shfrytëzoja dy të tretat e natës duke lexuar libra që më pëlqenin dhe duke e harxhuar gati të gjithë ditën në gjëra që më pëlqenin, si për shembull të jap përsëritje të mësimëve, mësim privat, ku shpesh herë e bëja falas o për miqësi, por nga të shumtët paguhesha.

Në atë kohë në Kieri një librashitës hebre që quhej Elia,⁸⁰ me të cilin lidha miqësi duke shkuar për të lexuar klasikët italian. Një grosh çdo vëllim që i ktheja mbas çdo leximi.⁸¹ Nga vëllimet e vogla të bibliotekës popullore lexoja një në ditë.⁸² Në vitin e katër të gjimnazit⁸³ u mora me leximin e veprave të autorëve italian. Në vitin e retorikës vendosa të bëj studime mbi klasikët latinë e dhe fillova të lexoj Cornelio Nepote, Cicerone, Sallustrio, Quinto Curzio, Tito Livio, Cornelio Tacito, Ovidio, Virgilio, Orazio Flacco dhe të tjerë. Unë lexoja ato libra për qejf dhe i shijoja thua se i kisha kuptuar tërësisht. Vetëm më vonë vura re që nuk ishte e vërtetë, për këtë arsye sa u bëra prift, duke qenë se do ti shpjegoja të tjerëve ato vepra klasike, arrita të kuptoj se vetëm më një studim të madh dhe shumë përgatitje arrija të hyja në thelbin e shijes dhe të bukurisë së tyre. Por detyra e të studiuarit, puna me konsultimet, leximet e shumta, më merrnin të gjithë ditën si dhe një pjesë të mirë të natës. Shpesh herë më ndodhet që arrinte ora e zgjimit dhe unë kisha akoma nëpër duar *Decadi* e Tito Livio,⁸⁴ që kisha filluar leximin e tij po atë natë. Kjo gjë më shkatërroi aq shumë shëndetin sa që për një kohë të gjatë jeta ime ishte shumë afër varrit. Prandaj, nga kjo, unë do t'ju këshilloj gjithmonë për gjërat që bëhen o që nuk duhen bërë. Nata është bërë për të pushuar përveç se në raste nevoje, përndryshe pas darke gjithsecili duhet ti kushtohet gjërave shkencore. Një njeri i fuqishëm mundet ti bëjë ballë për pak, por do të shkatërojë gjithmonë ndonjë dëm shëndetit të tij.

⁸⁰ Elia Foa, tregtarë stofash (sipas regjistrimit të popullsisë në 1834 kishte 79 vjeç), me dyqan të bashkuar me atë të kunatit librashitësit Tobia Iona, 59 vjeç.

⁸¹ Një grosh është i barabartë me 5 cent të një lire.

⁸² *Biblioteka Popullore Morale dhe Fetare* ishte një seri me njëqind vepra të vogla xhepi (rreth 200 faqe çdo vëllim), të publikuar çdo javë nga viti 1828 deri në 1830 me botues Giuseppe Pomba (1795-1876), që kushtonin 50 cent. “Zgjedhja e kujdesshme e teksteve dhe varieteti i temave – nga Imitimi i Krishtit në versionin e Cezarit, tek vepra e Omerit, Virgilit, Dantes, Petrarkës, Ariostos, Tassos, Metastasio, Manzonit dhe të tjerëve autorë të mëdhenj të literaturës, ishin të përjashtuar të gjitha veprat e huaja moderne”

⁸³ I katërti gjimnaz: sipas rregullit shkollor të kohës i korrespondon kursit të umanistës...

⁸⁴ Tito Livio (59 p.e.r. – 17 pas e.r.): më i madhi historian i epokës augusta, autor i Histori, një veprë monumentale i ndarë në periudha prej dhjetë vjetësh (*decadi*), nga e cila kanë mbetur vetëm pak pjesë (dekada I, III, IV dhe pesë librat e parë të dekadës së V).

14. Përgatitja – Zgjedhja e drejtimit

Ndërkohë po afrohej fundi i vitit të retorikës,⁸⁵ konë në të cilën studentët ëndërrojnë për të vendosur përreth vokacioneve të tyre. Ëndrrën e Morialdos e kisha gjithmonë me vete; bile shpesh herë më ishte rinovuar në mënyrë edhe më të qartë, për këtë, duke dashur ti rri besnik, duhet të zgjidhja drejtimin kishtar, që pikërisht ndihesha i drejtuar; por duke mos dashur ti besoj ëndrrave, dhe mënyrës time të të jetuarit, disa zakone të zemrës sime dhe mungesa e plotë e virtyeteve të nevojshme për këtë drejtim, e bëjnë shumë dyshues dhe të vështirë këtë marrje vendimi.

Oh sikur të kisha pasur në atë kohë një udhëheqës që të kishte pasur kujdes për vokacionin tim! Do të kishte qënë për mua një pasuri e madhe, por kjo pasuri më mungonte. Kisha një rrëfyes të mirë që mendonte të më bënte një krishterë të mirë, por me vokacionin nuk desh kurrë të përzihet.

Duke u këshilluar me veten time, mbasi kisha lexuar disa libra që gjeja për zgjedhjen e drejtimit, vendosa të hyja në Urdhërin Françeskan. Në se bëhem seminarist shekullar, flisja me vete, vokacioni im ka rrezik të mbytet. Do të përqafoj drejtimin kishtar, do të heq dorë nga bota, do të shkoj në manastir, do të jepem mbas studimit, meditimit, dhe kështu në vetmi do të mund të luftoj pasionet, në mënyrë të veçantë krenarinë që në zemrën time kishte zënë rrënjë të thella. Ndërkohë bëra kërkesë manastireve...., dhashë dhe provimet,⁸⁶ më pranuan dhe çdo u përgatit për të hyrë në kuvendin e Paqes në Chieri.⁸⁷ Pak ditë para kohës së përcaktuar për hyrjen time parë një ëndërr nga më të çuditshmet. Mu duk se pashë një mori priftash me veshje që vraponin në drejtime të ndryshme me njëri tjetrin. Një prej tyre vjen e më thotë: “Ti kërkon paqen e këtu paqen nuk do ta gjesh. Shih sjelljet e vëllezërve të tu. Vend tjetër, muajin tjetër Zoti do të përgatisë”.

Ia vlente t’ia bëja ndonjë mundje atij prift, por një zhurmë e fortë zgjoi dhe nuk pashë më asgjë. Ia tha të gjitha rrëfyesit tim, që nuk desh të dëgjonte dhe as të flisja as për ëndrrat as për fretërit. “Në këtë punë, mu përgjigj, është e nevojshme që secili të ndjekë prirjet e veta dhe jo këshillat e të tjerëve”.

Në atë kohë ndodhi një çështje që më vendosi në pamundësinë për të realizuar projektin tim. Dhe duke qënë se pengesat ishin të shumta dhe të zgjatura në kohë, kështu që unë vendosa të ja tregoi të gjitha shokut tim Comollos. Ai më këshilloi të bëj një nëndëshe, gjatë të cilës ai do ti kishte shkruar xhaxhait të tij prevosto. Ditën e fundit të nëndësches në shoqërinë e shokut të pandarë kam bërë rrëfimin dhe kungimin,

⁸⁵ Retorika: klasa e fundit e latinista superiore. Giovanni Bosco ka frekuentuar në vitin shkollor 1834-1835. Problemi i zgjedhjes së drejtimit të jetës, megjithatë, e kishte menduar me kohë: në fakt, kërkesa për hyrjen ndër Françekanët, për të cilën do të flasi më poshtë, u paraqit në mars të 1834, gjatë kursit umanita.

⁸⁶ Provimi u bë me 18 prill 1834 në kuvendin e në Torino, qendër e Provincës piemonteze e Udhërit; pranimi i u bë me 28 të vazhduesit.

⁸⁷ Kuvendi i Paqes: kështu quhej kuvendi i i Chierit,

pastaj pashë dhe meshë, dhe shërbeva në një tjetër në katedrale në elterin e Zojës së Hireve. Pasi si shkuam në shtëpi gjetëm në fakt një letër të Don Comollos e konceptuar në këto terma: “Konsideroni me kujdes gjërat që po ju paraqes, unë do të këshilloja shokun tënd ta shtyjë hyrjen e tij në një kuvend. Të veshi teshat kishtare, dhe ndërsa bën studimet e tija do të njohë më mirë atë që Zoti don prej tij. Mos ki aspak frikë të humbësh vokacionin, për këtë arsye pra me dhe me praktikat e mëshirës ai do të kapërcejë të gjitha vështirësitë”.

Kam ndjekur atë sugjerim të mençur, me qetësi kam bërë gjërat që do të mund të përfitoja për tu përgatitur për veshjen e pektit kishtar. Menjëherë pas provimit të retorikës, dhashë atë të veshje së klerikut në Chieri dhe pikërisht në dhomat aktuale në shtëpinë Bertinetti Carlo, që pas vdekjes la si trashigimi dhe që ishin të dhëna me qira arqiprftit kanonik Borzio. Atë vit provimi nuk u bë si zakonisht në Torino për arsye të *cholera-morbus* që kërcënonte vendet tona.⁸⁸ Dua këtu të vë në dukje një që bën të ditur se sa shpirti i mëshirës ishte i kultivuar në kolegjin e Chierit. Në distancën e katër viteve që frekuentova ato shkolla nuk më kujtohet të kem dëgjuar një diskutim o qoftë edhe një fjalë të vetme që ishin kundër sjelljes së mirë o kundër fesë. Me mbylljen e kursit të retorikës, prej 25 nxënësve, që përbëhej ajo klasë, 21 nga ato përqaftuan jetën kishtare, tre mjek, një tregtar.

Shkova në shtëpi për pushime, pushova së bëri si pelivan dhe u dhashë pas lexime të mira, që, me turp po e them, që deri atë herë kisha lënë pas dore. Megjithatë kam vazhduar të merrem me të djemtë, duke i mbajtur me tregime, gjatë pushime të këndëshme, me këngë të hymneve të shenjta, duke vërejtur që shumë prej tyre ishin të rritur, por shumë të paditur në të vertetën e fesë, pata kujdes ti mësoj atyre dhe lutjet e përditshme dhe të tjera gjëra më të rëndësishme në atë moshë.

⁸⁸ Kolera u përhap në disa vende të Pjemontes nga pranvera deri në vjesshtë të 1835. Sipas dispozitave qeveritare, për të evituar ngjitjen, arkipeshkve i Torinos vendosi që provimet e pranimit të veshjes së pektit kishtar të mos bëheshin, sipas zakonit, në kryeqytet, por pranë autoriteteve kishtare lokale.